



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 1725/ 10 prot.

Datë 20.08.2025

V E N D I M
Nr. 1096/2025

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 20.08.2025 shqyrtoi ankesën me:

Objekt: Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “Salillari” SHPK në procedurën e prokurimit “*Procedure e hapur*”, me Nr. REF-31297-11-27-2024, me objekt: “*Ndërtimi i godinës së Bashkisë*”, me fond limit 108.333.333 (njëqind e tetë milion e treqind e tridhjetë e tre mijë e treqind e tridhjetë e tre) lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 26.12.2024, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Dimal.

Ankimues: Operatori ekonomik “Salillari” SHPK, me NIPT J62903125G, me adresë Lagjia “4 Shtatori”, Ish Magazinat, Ura Vajgurore.

Autoriteti Kontraktor: Bashkia Dimal.
Adresa: Lagjia “18 Tetori”, Ura Vajgurore.

Subjekt i Interesuar: BOE “Ardmir” SHPK & “Asi-2A Co” SHPK, me NIPT K82509006P, me adresë Lagjia “Konizbalte”, Ura Vajgurore, Berat.

Baza Ligjore: Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4 i

Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V ë r e n:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Vlera limit e përllogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e lartë monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomikë ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 02.12.2024, në Sistemin e Prokurimeve Elektronike është publikuar procedura e prokurimit “*Procedure e hapur*”, me Nr. REF-31297-11-27-2024, me objekt: “*Ndërtimi i godinës së Bashkisë*”, me fond limit 108.333.333 (*njëqind e tetë milion e treqind e tridhjetë e tre mijë e treqind e tridhjetë e tre*) lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 26.12.2024, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Dimal.

II.2. Në datën 26.12.2024, autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

II.3. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor dhe sistemit të prokurimeve elektronike rezulton se në datën 07.03.2025, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH),

përkatësisht:

1. “Salillari” SHPK	91,873,659.47	lekë skualifikuar
2. BOE “Ardmir” SHPK & “Asi-2A Co” SHPK	103,581,885.331	lekë kualifikuar
3. “Ulza” SHPK	107,011,629.924	lekë kualifikuar
3. “Shendelli” SHPK	107,453,863.11	lekë kualifikuar

II.4. Në datën 14.01.2025, i operatori ekonomik “Salillari” SHPK është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave, si dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi me argumentet si më poshtë vijon:

Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur në platformën e prokurimit elektronik për procedurë me objekt “Nderimi i godinës së Bashkisë”, rezulton se ju nuk plotësoni pikën 4 të kriterëve të përgjithshme të kualifikimit. Referuar nenit 3, pika 4 d, nenit 21, paragrafi 2, të ligjit nr 9367 datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksioneve publike” i ndryshuar, si dhe nenit 30 të ligjit 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, rezulton se ju jeni në kushtet e konfliktit të interesit me Kryetarin e Keshillit Bashkiak Dimal.

II.5. Në datën 03.04.2025, autoriteti kontraktor ka publikuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik “Publikimi i Njoftimit Fituesit Paraprak” për procedurën e prokurimit objekt-shqyrtimi.

II.6. Referuar materialeve të fashikullit të shqyrtimit administrativ rezulton, se në datën 04.04.2025 nëpërmjetë sistemit të ankesave elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor, është administruar ankesa me nr. Elektronik A/2025/5214, dhe nr. 903/2025 prot, datë 07.04.2025 e operatorit ekonomik “Salillari” SHPK nëpërmjetë së cilës kundërshton vendimin e komisionit të vlerësimit të ofertave në lidhje me skualifikimin e ofertës së tij në këtë procedurë prokurimi objekt shqyrtimi me argumentat si më poshtë vijon:

Në datën 26.12.2024 shoqëria Salillari shpk ka marrë pjesë në procedurën e shpallur nga Autoriteti Kontraktor Bashkia Dimal me Objekt “Nderimi i godinës së Bashkisë” me nr reference REF-31297-11-27-2024, me fond limit 108.333.333,00 leke pa tvsh. Në datën 07.03.2025 jemi njoftuar në sistemin e prokurimit publik mbi vlerësimin e procedurës dhe refuzimin e ofertës sone:

Operator ekonomik	Vlera të ofertuara	Refuzuar
1. “Salillari” SHPK	91,873,659.47	lekë skualifikuar
2. BOE “Ardmir” SHPK & “Asi-2A Co” SHPK	103,581,885.331	lekë kualifikuar
3. “Ulza” SHPK	107,011,629.924	lekë kualifikuar
3. “Shendelli” SHPK	107,453,863.11	lekë kualifikuar

Arsyet e Refuzimit: Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur në platformën e prokurimit elektronik për procedurën me objekt “Ndertim i godines së Bashkisë” rezulton se ju nuk plotësoni pikën e kriterit të përgjithshëm të kualifikimit. Referuar nenit 3, pika 4 d, neni 21, paragrafi 2 të ligjit nr 9367 datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksioneve publike” i ndryshuar si dhe neni 30 të ligjit 44/2015 Kodi i Procedurës Administrative në Republikën e Shqipërisë i ndryshuar, rezulton se ju jeni në kushte të konfliktit të interesit me kryetarin e Këshillit Bashkiak Dimal. Në datën 03.04.2025 jemi njoftuar në sistemin e prokurimit publik (APP) mbi nisjen e afatit Afati i Ankimit për procedurën me nr reference REF-31297-11-27-2024 ka nisur! Duke e gjetur vendimin e komisionit të vlerësimit të ofertave të padrejta dhe në shkelje të ligjit dhe të parimeve të prokurimit publik referuar Neni 110 pika 2 të Ligjit për prokurimin publik të ndryshuar, me poshtë po ju paraqesim argumentat tona duke kundërshtuar vendimin e Autoritetit Kontraktor.

Autoriteti kontraktor ka vendosur refuzimin e ofertes së shoqërisë Salillari shpk në mënyrë të padrejta dhe në kundërshtim të hapur me legjislacionin në fuqi. Autoriteti Kontraktor konstaton në mënyrë gabuar duke keqinterpretuar Ligjin “Për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksioneve publike” i ndryshuar se shoqëria Salillari shpk është në kushte të konfliktit të interesit me Kryetarin e Këshillit Bashkiak Dimal. Në arsyetimin e tij, Autoriteti Kontraktor pretendon se shoqëria Salillari SHPK është në kushte konflikti i interesit me Kryetarin e Këshillit Bashkiak të Dimalit, duke u mbështetur në nenin 3, pika 4(d), neni 21, paragrafi 2 të Ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005 për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksioneve publike të ndryshuar, si dhe në nenin 30 të Ligjit nr. 44/2015, Kodi i procedurës Administrative në Republikën e Shqipërisë të ndryshuar. Ligjit nr 9367 datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksioneve publike” i ndryshuar Neni 21 pika 2 parashikon:

Neni 21 “Ndalimi i lidhjes së kontratave” parashikohet : 2. Kur zyrtari është në funksionin e kryetarit a të nënkryetarit të bashkisë, komunës ose të këshillit të qarkut, të anëtarit të këshillit përkatës ose është zyrtar i nivelit të lartë drejtues të një njësie të qeverisjes vendore, sipas interpretimit të këtij termi në ligjet përkatëse, ndalimi sipas pikës 1 të këtij neni, për shkak të interesave privatë të zyrtarit, të përcaktuara në këtë pikë, zbatohet vetëm në lidhjen e kontratave, sipas rastit, me bashkinë, komunën ose këshillin e qarkut, ku zyrtari ushtron këto funksione. Ky ndalim zbatohet edhe kur palë në kontratë është një institucion publik, në varësi të kësaj njësie.

Ligjit 44/2015 Kodi i Procedurës Administrative në Republikën e Shqipërisë i ndryshuar Neni 30: Neni 30 Pengesat ligjore

Nëpunësi publik ose anëtar i organit kolegjial nuk përfshihet në një procedurë administrative vendimmarrëse, në rastet kur:

- a) ka një interes personal të drejtpërdrejtë ose jo të drejtpërdrejtë në vendimmarrjen në shqyrtim;*
- b) bashkëshorti, bashkëjetuesi ose të afërmit e tij deri në shkallë të dytë kanë një interes të drejtpërdrejtë ose jo të drejtpërdrejtë në vendimmarrjen në shqyrtim;*

c) nëpunësi publik, ose anëtar i organit kolegjial ose edhe personat e parashikuar në shkronjën

Autoriteti Kontraktor ben nje interpretim te gabuar te dispozitave ligjore te mesiperme. Midis shoqerise Salillari dhe Kryetarit te Keshillit Bashkiak nuk ekziston asnje rast konflikt interesi. Nga ky neni, është e qartë se ndalimi i lidhjes së kontratave për zyrtarët nuk zbatohet në rastin e shoqërisë Salillari SHPK, pasi as Kryetari i këshillit Bashkiak të Dimalit dhe as shoqëria nuk janë subjekt i këtij rregulli në mënyrën e përcaktuar nga ligji.

Shoqeria Salillari shpk eshte person Juridik i rregjistruar ne perputhje me legjislacionin ne fuqi, me ortak z. Pellumb SALILLARI i cili zoteron 100% te kuotave te shoqerise dhe Administrator Z. Bledar Starova. AK ne menyre te gabuar, duke keqinterpretuar legjislacionin ne fuqi ka refuzuar oferten e shoqerise me argumentin se shoqeria eshte ne konflikt interesi me Kryetari i Keshillit Bashkiak (vella i Ortakut te shoqerise Salillari shpk).

Ligjit nr 9367 date 07.04.2005 “Per parandalimin e konfliktit te interesit ne ushtrimin e funksioneve publike” i ndryshuar ka percaktuar ne Nenin 3 - Perkufizim se cfare eshte konflikti i interesit: Neni 3 Perkufizim “Konflikt i interesit është gjendja e konfliktit ndërmjet detyrës publike dhe interesave privatë të një zyrtari, në të cilën ai ka interesa privatë, të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, që ndikojnë, mund të ndikojnë ose duket sikur ndikojnë në kryerjen në mënyrë të padrejtë të detyrave dhe përgjegjësive të tij publike.

Nga perkufizimi i nenit te mesiperm eshte e qarte se qe te ekzistoj konflikti i interesit duhet qe te kete nje interes private te drejteperdrejte ose te terthorte qe do te ndikojte ne ushtrimin e detyrave dhe pergjegjesive publike te funksionarit. Ndryshe nga cfare pretendon Autoriteti Kontraktor pjesemarrja e shoqerise Salillari shpk ne proceduren e prokurimi te zhvilluar nga Autoriteti Kontraktor në Bashkia Dimal nuk krijon asnje rast konflikt interesi, as kualifikimi i ofertes se shoqerise dhe aq me teper nenshkrimi i kontrates me Bashkine Dimal nuk krijojne asnje rast konflikt interesi midis shoqerise dhe Kryetarit te Keshillit Bashkiak.

Ne Ligjin Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen Vendore” jane percaktuar qarte detyrat dhe pergjegjesite e Kryetarit te Keshillit Bashkiak konkretisht:

Neni 56 pika 2 Ligji Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen Vendore” Kryetari i Keshillit ka detyra si me poshte:

Neni 56 pika 2,

Kryetari i këshillit bashkiak

- Kryetari i këshillit kryen këto detyra:

a) thërret mbledhjen e këshillit, në përputhje me nenin 53 të këtij ligji;

b) drejton mbledhjet e këshillit, në përputhje me rregulloren e tij;

c) nënshkruan aktet që nxjerr këshilli;

ç) kryen detyra të tjera, të përcaktuara në rregulloren e këshillit

Asnjera nga detyrat e mesiperme nuk lidhet me objektin e prokurimit dhe nuk krijon asnje ndikim apo interes privatë, të drejtpërdrejtë ose të tërthortë qe mund te ndikojë në kryerjen në mënyrë të padrejtë të detyrave dhe përgjegjësive publike te zyrtarit.

Gjithashtu ne Nenin 6 Ligjit nr 9367 date 07.04.2005 "Per parandalimin e konfliktit te interesit ne ushtrimin e funksioneve publike" i ndryshuar ka parashikur pergjegjesine dhe detyren e e vete zyrtarit per te zgjidhur vete ne menyren me te frytshme cdo rast te mundshem te konfliktit te interesit.

Neni 6 mënyra e kryerjes së detyrave publike dhe detyrimi për parandalimin e konfliktit të interesit 1. Me zgjedhjen ose emërimin e tij e në vazhdim, zyrtari ka për detyrë të parandalojë dhe të zgjidhë vetë, sa më parë dhe në mënyrën më të frytshme të mundshme, cdo gjendje të konfliktit të tij të interesit. Në rast se zyrtari nuk është i bindur për ekzistencën apo jo të një konflikti interesi të lidhur me të, ai duhet të këshillohet sa më parë me eprorët.

2. Cdo epror dhe institucion epror duhet të marrin të gjitha masat e nevojshme për të parandaluar dhe zgjidhur rastet e konfliktit të interesit.

Ne kuptim te Nenit te mesiperm eshte e qarte se nese do te ekzistonte nje rast konflikti i nteresis, ky nene parashikon qarte pergjegjesine dhe detyren e vete funksionarit publikë per te zgjidhur dhe per te krijuar një distancë të qartë mes interesave të tyre personale dhe atyre publike. Nese i referohemi Ligjit nr. 44/2015, Kodi i Procedurës Administrative në Republikën e Shqipërisë të ndryshuar, neni 30 pika b ka percaktuar:

Neni 30

Pengesat ligjore

Nëpunësi publik ose anëtar i organit kolegjal nuk përfshihet në një procedurë administrative vendimmarrës, në rastet kur:

- a) ka një interes personal të drejtpërdrejtë ose jo të drejtpërdrejtë në vendimmarrjen në shqyrtim;*
- b) bashkëshorti, bashkëjetuesi ose të afërmit e tij deri në shkallë të dytë kanë një interes të drejtpërdrejtë ose jo të drejtpërdrejtë në vendimmarrjen në shqyrtim;*

Edhe ne kete nene eshte percaktuar qarte se vetem ne rastin e nje interesi te drejteperdrejte ose jo te drejteperdrejte ne nje vendimarrje, zyrtari nuk mund te perfshihet ne nje vendimarrje. Nderkohe ne prokurimin publik te zhvilluar nga Autoriteti Kontraktor Bashkia Dimal nuk rezulton qe Kryetari i Keshillit Bashkiak te kete ndonje interes te drejteperdrejte ose jo drejteperdrejte ne vendmimarje.

Gjithashtu nuk rezulton qe pjesmarrja e shoqerise ne proceduren e prokurimit te zhvilluar nga Bashkia Dimal dhe kualifikimi i shoqerise te krijoje ndonje interes te drejteperdrejte ose jo drejteperdrejte ne ushtrimin e detyrave dhe funksioneve publike te Kryetarit te Keshillit Bashkiak te percaktuara nga ligji .

Perveç sa me sipër ne arsytimin e tij Autoriteti Kontraktor bie në kundëstym edhe me percaktimet e Dokumentave Standartet te Tenderit te shpallur prej tij konkretisht te Formularit te Vetedeklarimit -Deklarate C:

“Une deklaroj ketu se asnje zyrtar publik sic percaktohet ne Kapitullin III , Seksioni II i LIGJIT Nr.9367 date 07.04.2005 dhe ne kete deklartae nuk ka ndonje interes privat , direkt ose indirekt me personin juridik qe une perfaqesoj ketu”.

Per sa me siper eshte e qarte se midis Kryetarit te Keshillit Bashkiak dhe shoqerise nuk ekziston asnje interes privat, direkt ose indirekt qe mund te ndikojne ne kualifikimin e ofertes dhe aq me teper ne zbatimin e kontrates se puneve publike, pasi asnje nga detyrat dhe funksionet e Kryetarit te Keshillit Bashkiak nuk krijojnë një interes privat, direkt ose indirekt ne kete procedure prokurimi.

Per sa me siper duke e gjetur vendimin per skualifikim te shoqerise Salillari shpk ne kundeshitim me Dokumentat e Tenderit, me parimet e Ligjit per Prokurimin Publik dhe legjislacionin ne fuqi kerkojme shfryqezimin e vendimit te Autoritetit Kontraktor dhe kualifikimin e shoqerise Salillari ne proceduren “Ndertimi i Godines se Bashkise”

II.7. Bazuar në nenin 112 pika 3 të ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik” Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe formularin për publikim Nr. 903/1 prot., datë 08.04.2025, me arsyet e skualifikimit që operatori ekonomik “Salillari” SHPK kundërshton me anë të ankesës me nr. 903/2025 prot, datë 07.04.2025.

II.8. Nëpërmjet shkresës me nr. 1072 prot., datë 16.04.2025, protokolluar me tonën me shkresën nr. 903/2 prot., datë 17.04.2025 me objekt “Kthim përgjigje ankesës nr. 903/2025 prot, datë 07.04.2025” (ardhur nëpërmjetë sistemit të ankesave elektronike) është depozituar nga autoriteti kontraktor akti i trajtimit të ankesës së operatorit ekonomik ankimues, ku konstatohet, se autoriteti kontraktor ka vendosur mospranimin e ankesës me argumentat si vijon:

I.Analiza ligjore e fakteve dhe rrethanave

Së pari Ç’kuptojmë me konflikt interesi

Referuar rastit konkret, dhe ligjit nr. 9637, datë 07.04.2005 “Per parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar neni 3, pika 1 dhe pikës 4 paragrafi b dhe d cilësohet se:

1. “Konflik i interesit” është gjendja e konfliktit ndërmjet detyrës publike dhe interesave privatë të një zyrtari, në të cilën ai ka interesa privatë, të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, që ndikojnë, mund të ndikojnë ose duket sikur ndikojnë në kryerjen në mënyrë të padrejtë te detyrave dhe përgjegjësi të tij publike.

4. Konflikti i interesit, i përcaktuar në pikën 1 të këtij neni, përfshin disa përkufizime të tjera, për lloje të ndryshme të shfaqjes së tij, si më poshtë:

b) “Konflikt në dukje i interesit” është gjendja, në të cilën interesat private të zyrtarit duken, në pamje ose në formë, sikur kanë ndikuar, ndikojnë ose mund të ndikojnë në kryerjen në mënyrë të padrejtë të detyrave apo përgjegjësi të tij zyrtare, por, në fakt, ndikimi nuk ka ndodhur, nuk ndodh ose nuk ka mundësi të ndodhë:

d) “Konflikt i vazhdueshëm i interesit” është gjendja, në të cilën konflikti i interesit mund të shfaqet në mënyrë të përsëritur dhe/ose të shpeshtë në të ardhmen.

Ne referencë të ligjit nr. 9637 datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar neni 5, si dhe nenit 30 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar jemi përpara konfliktit në dukje të interesit, sepse rezulton që subjekti ankimues dhe Kryetari i Këshillit Bashkiak Dimal, kanë marrëdhënie familjare - janë përkatësisht vëllezër.

Kontrata që do të lidhej nëse do të kualifikohej duke mos patur parasysh këtë konflikt interesi do të lidhej brenda juridiksionit të Bashkisë Dimal, pra do të ishte në kundërshtim me neni 21 pika 2, KREU II, të ligjit nr. 9637 “Për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar ku cilësohet se:

Kur zyrtari është në funksionin e kryetarit ose të nënkryetarit të bashkisë, komunës ose të këshillit të qarkut, të anëtarit të këshillit përkatës ose është zyrtar i nivelit të lartë drejtues të një njësie të qeverisjes vendore, sipas interpretimit të këtij termi në ligjet përkatëse, ndalimi sipas pikes 1 të këtij neni, për shkak të interesave private të zyrtarit, të përcaktuara në këtë pikë, zbatohet vetëm në lidhjen e kontratave, sipas rastit, me bashkinë, komunën ose këshillin e qarkut, ku zyrtari ushtron këto funksione. Ky ndalim zbatohet edhe kur pale në kontratë është një institucion publik, në varësi të kësaj njësie.

Ky arsyetim bazohet në faktin që z.Avdulla Salillari është kryetar i Këshillit Bashkiak Dimal dhe përfaqëson këtë Këshill Bashkiak referuar nenit 7 të ligjit 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar, pra operon brenda juridiksionit të zonës në të cilën do të lidhet kontrata.

Përsa më sipër arsyetuar, e konfirmon edhe përmbajtja e Deklaratës së konfliktit të interesit, pjesë e shtojcës 8 të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, pika C- pjesë e dokumentave standarde të tenderit të publikuar në APP për procedurën objekt ankimimi e cila në përmbajtjen e vetë citon se:

Kur zyrtari është kryetar bashkie ose nënkryetar i një bashkie ose komune, ose kryetar i një këshilli rajonal, anëtar i këshillit përkatës, ose një zyrtar i lartë i menaxhimit të një njësie të qeverisjes vendore, ndalimi për shkak të interesave private të zyrtarit, specifikuar këtu, do të zbatohet vetëm në rastin e lidhjes së kontratave, nëse ka, me bashkinë, komunën ose rajonin ku zyrtari ushtron një detyrë të tillë. Ky ndalim do të zbatohet gjithashtu kur pala në kontratë është një institucion publik në varësi të kësaj njësie (neni 21, paragraf 2, Ligji Nr. 9367, datë 07.04.2005).

Në rastin konkret kontrata nuk duhej të nënshkruhet edhe në ndalimet e percaktuara të Deklaratës për konfliktin e interesit, ku cilësohet se:

Ndalimet e parashikuara në nenin 21, paragrafet 1, 2 të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, me përjashtimet përkatëse, do të zbatohen në të njëjtën masë edhe për personat e lidhur me zyrtarin, d.m.th. bashkëshortin, bashkëjetuesin, femijët madhorë e prinderit e zyrtarit dhe të bashkëshortit dhe bashkëjetuesit.

Duke qenë se është në kushtet e konfliktit në dukje ose të vazhdueshëm të interesit, referuar pikes nenit 3, pika 4 (b) dhe (d) të ligjit nr. 9637 “Per parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar ky Kryetar i Këshillit Bashkiak Dimal me funksionet që ka dhe kompetencat referuar ligjit nr. 139/2015 “Per Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar apo dhe në aktet e tjera ligjore apo nën ligjore që lidhet me ushtrimin e funksioneve të përgjegjësisë të organeve të vetëqeverisjes vendore dhe ligjit nr. 68/2017 “Per Financat e Vetëqeverisjes Vendore”, i ndryshuar cilësohet nga kushdo në konflikt në dukje /të vazhdueshëm të interesit pasi krijohet një gjendje konflikti e shprehur në nenin 3, pika 4 (b) dhe (d) të nenit të ligjit nr.9637 “Per parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar.

Përsa më sipër:

Pozicioni i Kryetarit të Këshillit, krijon një konflikt në dukje/ të vazhdueshëm të interesi, pasi interesat private të këtij të fundit në rastin konkret ose të ngjashme me to duken në pamje ose në forme sikur ka ndikuar /ndikojnë ose mund të ndikojnë në kryerjen në mënyrë të padrejtë të detyrave apo përgjegjësisë të tij zyrtare.

Referuar Sa ma sipër duke qenë se jemi në kushtet e konfliktit të interesit dhe subjekti ankimes nuk plotëson piken f të kriterëve të përgjithshme të kualifikimit pretendimi i tij nuk qëndron.

IV. Konkluzioni: Pretendimi i operatorit ankimes nuk qëndron

Sa më sipër komisioni vendos:

1. Refuzimin e ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik “Salillari” SHPK me NIPT J62903 125G me adresa: Lagjia “4 Shtatori”, Ish Magazinat, Ura Vajgurore.

II.9. Në datë 23.04.2025, Komisioni Prokurimit Publik mori vendimin Nr. 554/202, për verifikimin dhe nisjen e hetimit nëse operatori ekonomik ankimes “Salillari” SHPK ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit me z A. S Kryetar i Këshillit Bashkiak Dimal në kuptim të ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005 “Për Parandalimin e Konfliktit të Interesave në Ushtrimin e Funksioneve Publike” i ndryshuar, ku ka vendosur si më poshtë vijon:

- 1. Të propozojë kryerjen e hetimit nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave nëse operatori ekonomik ankimes “Salillari” SHPK pjesëmarrës në procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur”, me objekt*

“Ndërtimi i Godinës së Bashkisë” me Nr. REF-31297-11-27-2024, me fond limit: 108.333.333 (njëqind e tetë milion e treqind e tridhjetë e tre mijë e treqind e tridhjetë e tre) lekë, pa TVSH, zhvilluar në datën 26.12.2024 nga autoriteti kontraktor Bashkia Dimal. A ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit në kuptim të ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005 “Për Parandalimin e Konfliktit të Interesave në Ushtrimin e Funksioneve Publike” i ndryshuar, me zyrtarë të institucionit Bashkia Dimal, në cilësinë e autoritetit kontraktor.

2. *Në përfundim të hetimit, një kopje e aktit të inspektimit, së bashku me relacionin përkatës, t’i vihet në dispozicion Komisionit Prokurimit Publik.*

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

II.10. Njëpërmjet shkresës me nr. 2111/3 prot., datë 30.04.2025, me objekt “Njoftim” protokolluar me tonën me shkresën nr. 903/6 prot., datë 02.05.2025, është depozituar nga Inspektoriati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave informacion më përmbajtje si vijon:

Në vijim të shkresë suaj nr. 903/5 prot, datë 23.04.2025, ardhur më datë 28.04.2025, njëpërmjetë të cilës keni dërguar Vendimin e Komisionit të Prokurimit Publik me nr. 554, datë 23.04.2025, ju bëjmë me dije se:

Inspektoriati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, bazuar në ligjin nr. 9367, datë 07.04.2005 “Për Parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar, ka filluar menjëherë hetimin administrativ për verifikimin dhe trajtimin e rastit të dyshuar të konfliktit të interesave lidhur me procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur”, me objekt “Ndërtimi i godinës së bashkisë”, me nr. Ref-31297-11-27-2024, zhvilluar më datë 26.12.2024 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Dimal.

II.11. Njëpërmjet shkresës me nr. 2111/6 prot., datë 12.05.2025, me objekt “Kthim përgjigje” protokolluar me tonën me shkresën nr. 903/7 prot., datë 12.05.2025, është depozituar nga Inspektoriati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave informacion më përmbajtje si vijon:

Ne vijim te shkresës suaj nr.903/5 prot., date 23.4.2025, ardhur dhe protokolluar më datë 28.4.2025, ju bëjmë me dije se:

Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, bazuar ne ligjin nr.9367, date 7.4.2005 “Per parandalimin e konfliktit te interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar, perfundoi hetimin administrativ për verifikimin dhe trajtimin e rastit te dyshuar te konfliktit te interesave, lidhur me procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur”, me objekt “Ndërtimi i godinës së bashkisë”, me nr. Ref-31297-11-27-2024, zhvilluar më datë 26.12.2024 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Dimal.

Kështu, nga ana juaj u kerkua hetimi administrativ mbi verifikimin e parashtrimeve të autoritetit kontraktor Bashkia Dimal, në lidhje me skualifikimin e operatorit ekonomik

“Salillari” sh.p.k., nga procedura e prokurimit “Procedurë e hapur”, me objekt “Ndërtimi i godinës së bashkisë”, me nr. Ref-31297-11-27-2024, me arsyetimin se referuar nenit 3, pika 4 “d”, nenit 21, paragrafi 2 të ligjit nr.9367, datë 7.4.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar, ky operator ekonomik ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit me Kryetarin e Këshillit Bashkiak Dimal.

Ne funksion të verifikimit dhe trajtimit të rastit, Inspektorati i Lartë në zbatim të ligjit nr. 9367, date 7.4.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” i ndryshuar, kerkoi informacion dhe vënien ne dispozicion të dokumentacionit të plotë ne lidhje me procedurën e prokurimit, me objekt “Ndertimi i godinës së bashkisë”, që nga momenti i daljes se urdhrat të prokurimit deri në fazën aktuale.

Bashkia Dimal, me shkresën nr.1381 prot., date 5.5.2025 ka vënë ne dispozicion dokumentacionin e kerkuar, nga shqyrtimi i te cilit rezulton se:

- Me Vendim nr.3, date 19.6.2023 te Keshillit Bashkiak z.Avdulla Salillari eshte zgjedhur Kryetar i Këshillit Bashkiak Dimal.*
- Me Vendim nr.52, datë 26.12.2023 Keshilli Bashkiak ka miratuar Programin Buxhetor Afat Mesëm të Bashkisë Dimal për periudhën 2024 - 2026 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë Dimal për vitin 2024.*
- Me urdhër nr.765, date 8.10.2024 te Titullarit te Autoritetit Kontraktor Bashkia Dimal, znj. Juliana Memaj, në mungesë dhe me urdhër, Nënkyetar znj. Leonora Bebi, është ngritur Njësia e Prokurimit per hartimin e dokumentacionit ligjor për procedurën e prokurimit me objekt “Ndërtimi i godinës së Bashkisë” të përbërë nga anëtarët: Gerald Bolani, Marije Bizdani, Mateo Plaku.*
- Me urdhër nr.766, datë 8.10.2024 të Titullarit të Autoritetit Kontraktor Bashkia Dimal, znj. Juliana Memaj, në mungesë dhe me urdhër, Nënkyetar znj. Leonora Bebi, eshte vendosur te kryhet prokurimi për procedurën me objekt “Ndërtimi i godinës së Bashkise”, me fond limit 108,333,333.34 leke pa tvsh, vënë ne dispozicion nga te ardhurat e Bashkisë. Për zbatimin e këtij urdhri është ngarkuar Njësia e Prokurimit, i perbërë nga*
- Me urdhër nr.902, datë 27.11.2024 të Titullarit të Autoritetit Kontraktor Bashkia Dimal, znj. Juliana Memaj, në mungesë dhe me urdhër, Nënkyetar znj. Leonora Bebi, është krijuar Komisioni i Vleresimit të Ofertave, të procedures së prokurimit “E hapur”, me objekt “Ndërtimi i godines së bashkisë”, i përbërë nga: Rajmonda Shuka, Ilda Mule dhe Ingrid Shkëmbi.*
- Në zbatim të kuadrit ligjor në fuqi, Njesia e Prokuimit është mbledhur më datë 27.11.2024, per miratimin e dokumentave të tenderit, specifikimeve teknike dhe kriterëve te veçanta për kualifikim për procedurën me objekt “Ndërtim i godinës së bashkisë”.*
- Procesverbal i dorëzimit të ofertave, i mbajtur më datë 26.12.2024, nga Njesia e Prokurimit, ku konstatohet se janë paraqitur katër oferta nga operatorët ekonomikë.*
- Procesverbal i mbajtur më datë 26.12.2024, nga Komisioni i Vleresimit të Ofertave, për hapjen e ofertave të paraqitura nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën me objekt “Ndërtimi i godines së bashkisë”, ku rezultojnë:*
 - 1. B.O.E “ARDMIR” sh.p.k. & “ASI-2A CO” sh.p.k.*

2. "SHENDELLI" sh.p.k.

3. "ULZA" sh.p.k.

4. "SALILLARI" sh.p.k.

- Procesverbal i mbajtur më date 7.3.2025, nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, për vlerësimin e ofertave të paraqitura nga operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurën me objekt "Ndërtimi i godinës së Bashkisë", ku konstatohet, ndër të tjera, se kanë vendosur skualifikimin e operatorit ekonomik "Salillari" sh.p.k., për shkak se nuk plotëson pikën "f" të kriterëve të përgjithshme të kualifikimit. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, referuar nenit 3, pika 4 "d", nenit 21, paragrafi 2, të ligjit nr.9367, date 7.4.2005, i ndryshuar, si dhe nenit 30, të Kodit të Procedurës Administrative në Republikën e Shqipërisë, ka arritur në konkluzionin se operatori ekonomik "Salillari" sh.p.k. ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit me Kryetarin e Këshillit Bashkiak Dimal.

- Formulari i njoftimit të fituesit, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimit, nr.698/13 prot., date 2.4.2025.

- Formulari i ankesës për procedurën e Prokurimit Publik, me nr. Ref REF-31297-11-27, me objekt "Ndërtimi i godinës së Bashkisë", nga operatori ekonomik "Salillari" sh.p.k., drejtuar Bashkisë Dimal dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

- Urdhër i Titullarit të Autoritetit Kontraktor, nr.214, date 7.4.2025, për pezullimin e procedurës së prokurimit me objekt "Ndërtimi i godinës së Bashkisë" deri në marrjen e një vendimi përfundimtar nga Komisioni i Prokurimit Publik.

- Urdhër i Titullarit të Autoritetit Kontraktor Bashkia Dimal, znj. Juliana Memaj, në mungesë dhe me urdhër, Nenkryetar znj. Leonora Bebi, nr. 215, datë 7.4.2025, për ngritjen e Komisionit të shqyrtimit të Ankesave të Operatorit Ekonomik "Salillari" sh.p.k., me përberje: Rabushe Hoxha, Isi Shehu dhe Fatjona Gjoshi.

- Vendim i grupit të punës nr.1072/2 prot., date 16.4.2025, për marrjen në shqyrtim të ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik "Salillari" sh.p.k.

- Kthim përgjigje operatorit ekonomik "Salillari" sh.p.k.

- Vendim i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 554/2025, me objekt verifikimin e pretendimeve të autoritetit kontraktor Bashkia Dimal, në lidhje me skualifikimin e operatorit ekonomik "Salillari" sh.p.k., nga procedura e prokurimit "Procedurë e hapur", me objekt "Ndërtimi i godinës së Bashkisë", me nr. Ref-31297-11-27-2024, me fond limit: 108,333,333 leke pa TVSH, zhvilluar në date 26.12.2024, me pretendimin, se referuar nenit 3, pika 4 "d", nenit 21, paragrafi 2 të ligjit nr. 9367, date 7.4.2005 "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike", i ndryshuar, ky operator ekonomik ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit me Kryetarin e Këshillit Bashkiak Dimal.

Per më tepër, në funksion të hetimit administrativ, Inspektorati i Lartë i ka dërguar ftesë për t'u paraqitur në ILDKPKI, për të dhene shpjegime, lidhur me rastin e dyshuar të konfliktit të interesave Kryetarit të Këshillit Bashkiak Dimal, z. Avdulla Salillari, i cili dha shpjegime sipas procesverbalit datë 5.5.2025.

Konkretisht, në procesverbalin e dt. 5.5.2025, z. Avdulla Salillari sqaroi se: "Më datë 19.7.2023 është zgjedhur Anëtar i Këshillit Bashkiak Dimal. Këshilli Bashkiak funksionon në bazë të ligjit nr. 139/2014 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar dhe Rregulloren për

funksionimin e Këshillit Bashkiak. Keshilli Bashkiak merr vendim për miratimin e buxhetit ku bëhet specifika sipas zërave. Keshilli mbledhet në fund të vitit për miratimin e buxhetit për vitin pasardhës. Kryetari i Keshillit hap rendin e ditës dhe hedh për votim, ndarjen e buxhetit sipas zërave, sikurse është propozuar nga bashkia. Gjithashtu, ka bërë me dije se Vendimi i Keshillit Bashkiak për miratimin e buxhetit, ku përfshihet sipas zërave dhe ndërtimi i godinës së bashkisë, ka kaluar për miratim në Prefekturën e Qarkut. Pas pjesëmarrjes në mbledhjen e Keshillit Bashkiak për miratimin e buxhetit, Kryetari i Keshillit nuk përfshihet me asnjë akt apo vendimmarrje, në lidhje me ndërtimin e godinës së bashkisë. Në lidhje me pjesëmarrjen e operatorit ekonomik “Salillari” sh.p.k, me ortak zotërues 100% të aksioneve z. Pellumb Salillari, sqaroi se z. Pellumb Salillari është vëllai i tij. Gjithashtu, shtoi se e njeh shumë mirë ligjin për konfliktin e interesave dhe ligjin për veteqeverisjen vendore, si dhe ndalesat e kufizimet që percaktohen për zyrtarët. Në rastin konkret, nga ana e tij nuk ka pasur asnjë vendimmarrje në lidhje me shoqerine “Salillari” sh.p.k. Në këtë procedurë prokurimi, pasi në mbledhjen e Këshillit miratohet vetëm buxheti për vitin, ku përfshihet dhe miratimi i fondit për ndërtimin e godinës, pa pasur asnjë dijeni për zhvillimin e procedurave të mëtejshme apo operatorët ekonomike pjesëmarrës në procedurën e prokurimit që zhvillon bashkia. Pas miratimit të buxhetit nga Keshilli Bashkiak, çdo procedurë në lidhje me prokurimin publik, zhvillohet nga autoriteti kontraktor, që është Bashkia Dimal”.

Ne vijim, më datë 7.5.2025, në ILDKPKI është administruar dokumentacion nga z. Avdulla Salillari, si më poshtë:

- Vendim i Këshillit Bashkiak Dimal nr.66, datë 27.12.2024, për miratimin e Programit Buxhetor Afat Mesëm të Bashkisë Dimal, për periudhën 2025 - 2027 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë Dimal, për vitin 2025.
- Shkresë e Prefektit të Qarkut Berat nr.902/2 prot., date 9.1.2025 “Për verifikimin e ligjshmërisë së akteve”.
- Rregullore e Këshillit Bashkiak, miratuar me Vendim të Këshillit nr.24, datë 9.4.2020.

Për sa më sipër, sjellim në vëmendje se, Ligji nr. 9367, datë 7.4.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar, ka si objekt percaktimin e rregullave, mjeteve, mënyrave, procedurave, përgjegjësisë dhe kompetencave, për identifikimin, deklarimin, regjistrimin, trajtimin, zgjidhjen dhe dënimin e rasteve të konfliktit të interesave.

Me qëllim parandalimin e konfliktit të interesave, Ligji nr. 9367, date 7.4.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar, Kreu III, Seksioni 1 “Kufizime të interesave private të zyrtarit për parandalimin e konfliktit rast për rast të interesit për çështje të veçanta”, në nenin 21 ka parashikuar “Ndalimin e lidhjes së kontratave”.

Ligji nr. 9367/2005, i ndryshuar, në nenin 21, parashikon dy lloje ndalimesh për lidhjen e kontratave me autoritetet publike:

- Ndalimi i natyrës absolute
- Ndalimi i natyrës relative

Ndalimi i natyres “absolute” lidhet vetëm me kategorinë e zyrtarit, pra me funksionin e tij dhe nuk varet ne asnjë moment nga kompetenca thelbësore e percaktuese apo jo e zyrtarit ne lidhjen e kontratave. Ky ndalim zbatohet jo vetëm nëse zyrtari merr pjesë në menyrë te drejtpërdrejte ne lidhjen e nje kontrate, por edhe në rastet kur interesi i zyrtarit në lidhjen e kontratës shfaqet në mënyrë te terthorte. Qëllimi i ndalimit “absolut” është shmangia e çdo konflikti te interesit, perfshirë atë në dukje per kategori specifike zyrtarësh.

Ndalimi i natyrës “relative” lidhet me konfliktin rast per rast te interesit, për një vendimmarrje që perfundon në lidhjen e një kontrate, mënyra e vetme e zgjidhjes të së cilës është mospërfshirja e një zyrtari në atë vendimmarrje, kur ai ka interesa që do të shkaktonin konflikt te interesave.

Konkretisht neni 21, pika 2 percakton: “Kur zyrtari është ne funksionin e kryetarit a te nënkryetarit të bashkisë, komunës ose të keshillit të qarkut, te anëtarit të keshillit perkatës ose është zyrtar i nivelit të lartë drejtues të një njësie të qeverisjes vendore, sipas interpretimit të ketij termi në ligjet përkatëse, ndalimi sipas pikës 1 te këtij neni, për shkak të interesave private të zyrtarit, të percaktuara në këtë pikë, zbatohet vetëm në lidhjen e kontratave, sipas rastit, me bashkinë, komunën ose keshillin e qarkut, ku zyrtari ushtron këto funksione. Ky ndalim zbatohet edhe kur palë në kontratë është një institucion publik, në varësi të kësaj njësie”.

Per qëllim te ndalimit te parashikuar nga neni 21, rrethi i personave të lidhur me zyrtarin përcaktohen shpeshimit në nenin 24 të ligjit nr.9367/2005, i ndryshuar, ku parashikohet se: “Rrethi i personave të lidhur me zyrtarin, në zbatim të ndalimeve të përcaktuara në nenin 21 dhe në nenin 22 te ketij ligji, perbëhet nga bashkëshorti/ja, bashkëjetuesi/ja femijët në moshë madhore dhe prindërit e zyrtarit e të bashkëshortit/es dhe bashkëjetuesit/es....

Për sa më sipër, në rastin e dyshimit te pranisë se interesave private, ne menyre të terthortë me zyrtarin në perfitimin nga një kontratë publike, parashikimet e nenit 21 duhet te interpretohen te nderlidhura me parashikimet e nenit 24 “Kufizimi i interesave të personave të lidhur me zyrtarin” të ligjit nr. 9367/2005, i ndryshuar.

Kështu, nga të dhënat e administruara rezulton, se zyrtari z. Avdulla Salillari, i përket kategoris se zyrtarëve që perfshihen në ndalimin absolut të parashikuar nga neni 21, pika 2, të Ligjit nr. 9367/2005, i ndryshuar, për lidhjen e kontratave brenda juridiksionit te njesisë vendore, ku ushtron funksionin e tij. Ndalim, i cili ne zbatim të nenit 24 të ligjit nr. 9367/2005, i ndryshuar, per personat e lidhur shtrihet tek “bashkëshorti/ja, bashkëjetuesi/ja femijet në moshë madhore dhe prindërit e zyrtarit e të bashkëshortit/es dhe bashkëjetuesit/es....”

Sa më siper, në zbatim të nenit 21 dhe 24, te ligjit nr. 9367/2005, i ndryshuar, vëllai i Kryetarit te Këshillit Bashkiak, nuk perfshihet në rrethin e personave te lidhur me zyrtarin, për te cilin të gjejë zbatim i njëjti ndalim qe ekziston edhe për vetë Kryetarin e Këshillit Bashkiak.

Megjithatë, analizimi i rastit duhet të vijojë për të vlerësuar, nëse ekzistojnë kushtet e një ndalimi relativ, konflikt rast për rast i interesave, në lidhjen e një kontrate publike.

Kështu, në pikën pikën 3, të nenit 21 të ligjit parashikohet se: “Pavaresisht percaktimeve të bëra në pikat 1 e 2 të këtij neni, ndalohet lidhja e kontratave ndërmjet një institucioni publik apo çdo institucioni publik tjetër të varësisë, nga njëra anë dhe një individ, personi fizik a juridik apo ndonjë formë tjetër ortakërie, nga ana tjetër, kur plotësohen, njëkohësisht, kushtet e mëposhtme:

a) zyrtari, që ushtron funksionet në këtë institucion publik ka kompetencë thelbësore dhe percaktuese në vendimmarrjen e procesit të vlerësimit të ofruesve dhe të ofertave apo në percaktimin e termave të kontratës;

b) ky zyrtar ka një interes privat, sipas percaktimeve të nenit 37 të Kodit të Procedurave Administrative, apo të nenit 709 të Kodit Civil, ose ka një interes të llojit të percaktuar në pikat 1 e 2 të këtij neni”.

Per sa më sipër duhet të vlerësohet në mënyrë kumulative ekzistenca e kushteve të mëposhtme:

1. A ka zyrtari kompetencë thelbësore dhe percaktuese në vendimmarrjen e procesit të vlerësimit të ofruesve dhe të ofertave apo në percaktimin e termave të kontratës? Dhe;

2. A ka zyrtari një interes privat, sipas percaktimeve të nenit 30 të Kodit të Procedurave Administrative?

Kështu, ndalimi në këtë rast i takon momenteve kur zyrtari, pavaresisht funksionit të tij, në rast se ka kompetencë thelbësore dhe percaktuese në vendimmarrjen përkatëse, e cila synon arritjen e finalizimit të kontratave apo akteve administrative që të çojnë tek lidhja e kontratave dhe ka një interes privat sipas nenit 30 të K.Pr. Administrative, atëherë zyrtari është subjekt i ndalimit, si të gjithë zyrtarët e tjerë të përmendur specifikisht.

Për më tepër, referuar ‘Manualit Shpjegues dhe Trajnimi mbi Parandalimin e Konfliktit të Interesave Nr. 1’, publikuar në faqen online të ILDKPKI, ëë.ildkpk.al, ndalimi i lidhjes së kontratave sipas nenit 21, pika 3 është një formulim i detyrimit për të shmangur konfliktin rast për rasti të interesit, lidhur me një vendimmarrje, e cila është pjesë e një procesi kontraktimi që realizohet nga një institucion publik. Kjo do të thotë, se ky ndalim aktivizohet për çdo zyrtar që ka interesa të tilla që do të ndikojnë në kryerjen e padrejete të detyrës, kur ky zyrtar ka rol thelbësor e percaktues në lidhjen e një kontrate nga institucioni publik, ku ai ushtron funksionin. Shprehja “çdo zyrtar” do të thotë edhe ata të percaktuar në pikat 1 e 2 të nenit 21, gjithashtu edhe ata të përjashtuar në pikën 1 apo të përmendur në këto dy pika, por tashmë për një sferë shumë më të gjerë interesash, pasurore dhe jopasurore (neni 30 Kodi i Procedurave Administrative).

Në zbatim të ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005, i ndryshuar, në shkronjen “c” të pikës 2, të nenit 4, percaktohet kompetenca thelbësore dhe percaktuese si vijon: “Një zyrtar” ka kompetencë thelbësore dhe percaktuese për një akt, nëse pjesëmarrja, ndikimi dhe qendrimi i tij në vendimmarrjen për këtë akt, sipas shkronjave “a” ose “f” të kësaj pike, percaktojnë përmbajtjen e aktit”.

Ndërsa, neni 30 “Pengesat ligjore” i Kodit të Procedurave Administrative, përcakton se: “Nepunësi publik ose anëtar i organit kolegjial nuk përfshihet në një procedurë administrative vendimmarrëse, në rastet kur: a) ka një interes personal të drejtpërdrejtë ose jo të drejtpërdrejtë në vendimmarrjen në shqyrtim; b) bashkëshorti, bashkëjetuesi ose të afërmit e tij deri në shkallë të dytë kanë një interes të drejtpërdrejtë ose jo të drejtpërdrejtë në vendimmarrjen në shqyrtim; c) nepunësi publik, ose anëtar i organit kolegjial ose edhe personat e parashikuar në shkronjën “b”, të këtij neni, kanë një interes të drejtpërdrejtë ose jo të drejtpërdrejtë, në një çështje objektive të njëjtte dhe me të njëjtat rrethana ligjore me çështjen në shqyrtim... g) nepunësi publik ose anëtar i organit kolegjial ose personat e përmendur në shkronjën “3” të këtij neni, kanë marrëdhënie të tilla, të cilat vlerësohen sipas rrethanave konkrete se do të përmbanin arsye serioze për njëanshmëri me palët, në procedurën administrative në shqyrtim”;

Sa më sipër, nga analiza dhe trajtimi në tërësi i të dhënave të administruara në funksion të hetimit administrativ, si dhe bazuar në funksionet dhe kompetencat e Këshillit Bashkiak, referuar kuadrit ligjor në fuqi, rezulton se:

Z. Avdulla Salillari, me funksion Kryetar i Këshillit Bashkiak Dimal, ndonëse është në rrethin e personave të parashikuar nga neni 30 i K.Pr. Administrative, nuk rezulton të jete i angazhuar apo i përfshirë në asnjë vendimarrje apo fazë të procedurës së prokurimit publik, me objekt “Ndërtimi i godines së Bashkisë”, me nr. Ref-31297-11-27-2024, të zhvilluar nga autoriteti kontraktor Bashkia Dimal, dhe nuk ka kompetencë thelbësore dhe përcaktuese në vendimmarrjen përkatëse që mund të ndikojë apo favorizojë shoqërinë “Salillari” sh.p.k.

Në analize të sa më sipër, në përfundim të hetimit administrativ, bazuar në ligjin nr. 9367, datë 7.4.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar, vlerësohet se, pjesëmarrja e operatorit ekonomik “Salillari” sh.p.k., me aksioner z. Pëllumb Salillari, në procedurën e prokurimit “Procedure e hapur”, me objekt “Ndërtimi i godines së Bashkisë”, me nr. Ref-31297-11-27-2024, zhvilluar në datë 26.12.2024 nga autoriteti kontraktor Bashkia Dimal, nuk gjendet në kushtet e konfliktit të interesit për shkak të qenies së vëllait të z. Salillari në funksionin e Kryetarit të Këshillit Bashkiak Dimal.

II.12. Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosjen e shqyrtimit administrativ, si dhe bazuar në informacionin e Autoritetit Kontraktor, u konstatua se nuk ka pasur pretendime nga subjekte të interesuara, në përputhje me nenin 113 të ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”.

II.13. Me datë 14.05.2025, me Vendimin nr. 688/2025 Komisioni Prokurimit Publik vendosi:

- 1. Të pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Salillari” SHPK për procedurën e prokurimit “Procedure e hapur”, me Nr. REF-31297-11-27-2024, me objekt: “Ndërtimi i godinës së Bashkisë”, me fond limit 108.333.333 (njëqind e tetë*

miljon e treqind e tridhjetë e tre mijë e treqind e tridhjetë e tre) lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 26.12.2024, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Dimal.

- 2. Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO-së, për skualifikimin e operatorit ekonomik “Salillari” SHPK dhe të korrigjojë shkeljet e konstatuara si më sipër, duke e kualifikuar këtë operator ekonomik.*
- 3. Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.*
- 4. Ngarkohet zyra e financës, që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Salillari” SHPK.*
- 5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.*
- 6. Kopje e këtij vendimi, i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.*

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

II.14. Me shkresën nr. 1072/6 prot., datë 23.05.2025, me objekt “Njoftim mbi zbatimin e vendimit të KPP-së nr. 668/2025, datë 14.05.2025”, protokolluar me tonën nr. 908/12 prot., datë 26.05.2025, autoriteti kontraktor Bashkia Dimal., lidhur me zbatimin e vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 668/2025, datë 14.05.2025, duke e rivlerësuar ofertën e operatorit ekonomik “Salillari” SHPK në procedurën e prokurimit “Procedure e hapur”, me Nr. REF-31297-11-27-2024, me objekt: “Ndërtimi i godinës së Bashkisë”, me fond limit 108.333.333 (njëqind e tetë milion e treqind e tridhjetë e tre mijë e treqind e tridhjetë e tre) lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 26.12.2024, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Dimal. Referuar shkresës së mësipërme, të dorëzuar nga autoriteti kontraktor pranë Komisionit të Prokurimit Publik, Komisioni vëren se, autoriteti kontraktor nëpërmjetë shkresës së mësipërcituar ka dërguar pranë Komisionit Prokurimit Publik praktikën për zbatimin e vendimit nr. 668/2025 datë 14.05.2025, të KPP. Nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik dhe raport auditit KPP konstaton se autoriteti kontraktor ka kryer rivlersimin e procedurës duke rishikuar statusin e operatorit ekonomik “Salillari” SHPK ku nga i skualifikuar rezulton i kualifikuar. Ndaj në këto kushte, rezulton se autoriteti kontraktor ka marrë masat e nevojshme në zbatim të përcaktimeve të bëra në vendimin KPP 668/2025, datë 14.05.2025 për procedurën e prokurimit objekt ankimi.

II.15. Me datë 26.05.2025, me Vendimin nr. 696/2025 Komisioni Prokurimit Publik vendosi:

- 1. Të lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit “Procedure e hapur”, me Nr. REF-31297-11-27-2024, me objekt: “Ndërtimi i godinës së Bashkisë”, me fond limit 108.333.333 (njëqind e tetë milion e treqind e tridhjetë e tre mijë e treqind e tridhjetë e tre) lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 26.12.2024, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Dimal.*

2. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

II.16. Në datën 25.06.2025, i operatori ekonomik “Salillari” SHPK është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave, si dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi me argumentet si më poshtë vijon:

E skualifikoj sepse nga shqyrtimi i dok fizik te paraqitur prane autoritetit kontraktor,rezultuan mangesite si vijon:

1- Operatori nuk ploteson nen piken 4 te pikës 2.3.9 Kapaciteti teknik Paisje e mjete:

1.1 Kapaciteti mbajtes i mjetit BR 5216 A eshte 10.3 ton

1.2 Kapaciteti mbajtes i mjetit AA 217 PR eshte 10.5 ton

Këto mjete nuk kanë tonazhin e përcaktuar nga Autoriteti Kontraktor, pasi kapaciteti mbajtës i tyre duhet të jetë nga 8 ton deri ne 10 ton, ndërkohë që këto dy mjete e kanë tonazhin më të madh se 5 deri ne 10 ton, dhe me konkretisht 10.3 ton dhe 10.5 ton , duke mosplotësuar kërkesës për tonazhin e mjeteve.

2- Nuk plotesohet nenpika 11 e pikës 2.3.9 Kapaciteti teknik Paisje e mjete, sepse mjetet me targë AB 233 OB, dhe AB 247 OB, e kane kapacitetin mbajtes me pak se 35 ton, me konkretisht 24 ton dhe 28 ton. 3-Damperat Cat model 771D sipas fatures 217 datë 20.06.2012, dhe fatures 205 datë 07.06.2012, nuk janë të pajisur me leje qarkullimi, certificate e kontrollit teknik te mjeteve rrugore, si dhe police per sigurimin e detyrueshem te mbajtesve te mjeteve motorike.

4- Mjetet e paraqitura me targë AA 254 TE, dhe ABR 342 janë kamion me rimorkio, jo dampera.

5- Mjetet me targë AA 398 SU dhe ADR 805 jane trajle, jo dampera.

II.17. Në datë 26.06.2025 autoriteti kontraktor ka publikuar në SPE “Formular Njoftim -Fituesi Paraprak”, për procedurën e prokurimit nga ku është shpallur fitues bashkimi i operatorëve ekonomikë “Ardmir” SHPK & “Asi-2A Co” SHPK.

II.18. Referuar materialeve të fashikullit të shqyrtimit administrativ rezulton, se në datën 01.07.2025 nëpërmjetë sistemit të ankesave elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor, është administruar ankesa me nr. Elektronik A/2025/5500, dhe nr. 1725/2025 prot, datë 01.07.2025 e operatorit ekonomik “Salillari” SHPK, nëpërmjet së cilës kundërshton vendimin e komisionit të vlerësimit të ofertave në lidhje me skualifikimin e ofertës së tij nga kjo procedurë prokurimi me argumentat si vijon:

Argumentime mbi shkeljet e pretenduara

Përshkrimi i shkeljeve të pretenduara

Ne datën 26.12.2024 shoqëria Salillari shpk ka marrë pjesë në procedurën e shpallur nga Autoriteti Kontraktor – Bashkia Dimal me Objekt “ Nderim i godinës së Bashkisë ” me nr reference REF-31297-11-27-2024 , me fond limit 108.333.333,00 leke pa tvsh .
Ne datën 07.03.2025 jemi njoftuar në Sistemin e Prokurimit Publik mbi vlerësimin e procedurës dhe refuzimin e ofertës sone

Operator ekonomik	Vlera të ofertuara	Refuzuar
SALILLARI	91873659.47	PO
ARDMIR	1036581885.33	JO
ULZA	107011629.92	JO
SHENDELLI	107453863.11	JO

Arsyet e Refuzimit:

Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur në platformën e prokurimit elektronik për procedurën me objekt “ Nderim i godinës së Bashkisë ” rezulton se ju nuk plotësoni pikën 4 të kriterit të përgjithshëm të kualifikimit . Referuar nenit 3, pika 4 d , nenit 21 , paragrafi 2 të ligjit nr 9367 date 07.04.2005 “ Për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksioneve publike ” i ndryshuar si dhe nenit 30 të ligjit 44/2015 Kodi i Procedurës Administrative në Republikën e Shqipërisë i ndryshuar , rezulton se ju jeni në kushte të konfliktit të interesit me kryetarin e Keshillit Bashkiak Dimal
Ne datën 03.04.2025 jemi njoftuar në sistemin e prokurimit publik (APP) mbi nisjen e afatëve të ankimit “Afati i Ankimit për procedurën me nr reference REF-31297-11-27-2024 ka nisur !”

Duke e gjetur vendimin e komisionit të vlerësimit të ofertave të padrejta dhe në shkelje të ligjit dhe të parimeve të prokurimit publik referuar Nenit 110 pika 2 të Ligjit për prokurimin publik të ndryshuar Shoqëria Salillari shpk në datën 04.04.2025 ka paraqitur Ankese pranë Bashkisë Dimal dhe Komisionit të Prokurimit Publik , në të cilën ka kërkuar Shfrytëzimin e Vendimit të Skualifikimit të Operatorit Ekonomik dhe Kualifikimin e Shoqërisë Salillari shpk

Komisioni i Prokurimit Publik pasi ka shqyrtuar ankesën me vendim nr 668/2025 ka vendosur Pranimin e Ankësës dhe kualifikimin e operatorit Ekonomik Salillari shpk

Ne datën 23.05.2025 jemi njoftuar në sistemin e Agjensisë së Prokurimit Publik -APP në lidhje me vlerësimin e kryer nga Autoriteti Kontraktor -Bashkia Dimal dhe kualifikimin e ofertës së shoqërisë Salillari shpk .

Operator ekonomik	Vlera të ofertuara	Refuzuar
SALILLARI	91873659.47	JO
ARDMIR	1036581885.33	JO
ULZA	107011629.92	JO
SHENDELLI	107453863.11	JO

Në përputhje me Ligjin për Prokurimin publik dhe në zbatim të kërkesave dhe kriterëve të përcaktuara në Dokumentat Standarte të Tenderit Autoriteti/entikontraktor përpara publikimit të njoftimit të futesit do t'i kërkojë ofertuesit të kualifikuar nëpërmjet Sistemit të Prokurimit Elektronik që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet e bëra në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e tjera të paraqitura në sistemin elektronik të prokurimit gjatë fazës së ofertimit, në datën 27.05.2025, nëpërmjet shkresës me nr 753 prot kemi dorëzuar dokumentacionin fizik të njësuar kopje me origjinalin pranë Bashkisë Dimal , me nr prot 1565, date 27.05.2025., me objekt “ Dorezim dokumentacioni të tenderit me objekt “Nderim i godinës së Bashkisë ”
Ne datën 25.06.2025 jemi njoftuar me mesazh nëpërmjet sistemit të prokurimit publik se AK ka refuzuar ofertën e shoqërisë Salillari shpk me arsyet si më poshtë :
Operatori nuk plotëson nën pikën 4 të pikës 2.3.9 Kapaciteti teknik Paisje e mjete:
1.1 Kapaciteti mbajtës i mjetit BR 5216 A është 10.3 ton ,1.2 Kapaciteti mbajtës i mjetit AA 217 PR është 10.5 ton- Keto mjete nuk kanë tonazhin e përcaktuar nga Autoriteti Kontraktor, pasi kapaciteti mbates i tyre duhet të jetë nga 8 ton deri në 10 ton, ndërkohë që këto dy mjete e kanë tonazhin me të madh se 5 deri në 10 ton, dhe me konkretisht 10.3 ton dhe 10.5 ton, duke mosplotësuar kërkesën për tonazhin e mjeteve.
2-Nuk plotësohet nëpika 11 e pikës 2.3.9 Kapaciteti teknik Paisje e mjete, sepse mjetet me targe AB 233 OB, dhe AB 247 OB, e kanë kapacitetin mbajtës me pak se 35 ton, me konkretisht 24 ton dhe 28 ton. 3-Damperat Cat model 771D sipas fatures 217 date 20.06.2012, dhe fatures 205 date 07.06.2012, nuk janë të pajisur me leje qarkullimi, certifikate e kontrollit teknik të mjeteve rugore, si dhe police për sigurimin e detyrueshëm të mbatesve të mjeteve motorike.4. Mjetet e paraqitura me targe AA 254 TE, dhe ABR 342 janë kamion me rimorkio, jo dampera. Mjetet me targe AA 398 SU dhe ADR 805 janë trajle, jo dampera.
Në Buletinin e datës 30.06.2025 nr 33 jemi njohur me Njoftimin paraprak të futesit- Ardmir shpk të publikuar nga Bashkia Dimal në fund të së cilës citohet “ Me publikimin e këtij njoftimi fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimit të nenit 110 të ligjit Nr 162/2020 date 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik i ndryshuar”

Ndërkohë deri në datën e kësaj ankese nuk jemi njoftuar në sistemin e APP me mesazh për nisjen e afatit të ankimit, pavarësisht kësaj duke qenë se jemi njohur nëpërmjet Buletinit date 30.06.2025 nr 33 me Njoftimin paraprak të futesit dhe duke e gjetur vendimin e skualifikimit të padrejtë po ju drejtohem me këtë ankese si më poshtë vijon :

4. Argumentime mbi shkeljet e pretenduara

Përshkruani në mënyrë koncize shkeljet e pretenduara, duke argumentuar qartë dhe saktë se përse pretendoni për paligjshmëri në veprimet e autoritetit/entit kontraktor.

Autoriteti kontraktor- Bashkia Dimal ka vendosur Skualifikimin e ofertës së shoqërisë Salillari shpk për procedurën me objekt “ Nderim i Godinës së Bashkisë ” në mënyrë të padrejtë dhe në kundërshtim të hapur me Legjisllacionin në fuqi.

Ne lidhje me konstatimin e AK se Operatori nuk ploteson nen piken 4 te pikes 2.3.9 Kapaciteti teknik Paisje e mjete: 1.1 Kapaciteti mbajtes I mjetit BR 5216 A eshte 10.3 ton ,1.2 Kapaciteti mbajtes I mjetit AA 217 PR eshte 10.5 ton- Keto mjete nuk kane tonazhin e percaktuar nga Autoriteti Kontraktor, pasi kapaciteti mbates i tyre duhet te jete nga 8 ton deri ne 10 ton, nderkohe qe keto dy mjete e kane tonazhin me te madh se 5 deri ne 10 ton, dhe me konkretisht 10.3 ton dhe 10.5 ton, duke mosplotesuar kerkesen per tonazhin e mjeteve.

AK ne Dokumentat Standarte te Tenderit ka percaktuar kriteret e kualifikimit dhe ne daten 12.12.2025 ka hedhur ne sistemin APP edhe Shtojcen per modifikim te kriterëve te DST sipas te ciles ka kerkuar si me poshte vijon :

2.3.9 Kapaciteti teknik Paisje e mjete

Disponimi ose mundësia e sigurt e disponimit në paisjet/kapacitete te mëposhtme teknike, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës:

- | | | | |
|---|---------|---|--|
| Pershkrimi i Automjetit | Sasia | Gjendja | |
| 1 Eskavator me goma 0.25m3 (MT) | 2 copë | Pronësi ose me qera | |
| 2 Fadroma | 2 copë | Pronësi ose me qera | |
| 3 Kamionëveteshkarkues me kapacitetmbajtës 10 -20 Ton | 2 copë | Pronësi ose me qera | |
| 4 Kamion vetshkarkues me kapacitetmbajtës 8 -10 ton | 2 copë | Pronësi ose me qera | |
| 5 Kamioncine me kapacitetmbajtës 3.5-5 ton | 2 copë | Pronësi ose me qera | |
| 6 Kamioncine me kapacitetmbajtës 1-3 ton | 2 copë | Pronësi ose me qera | |
| 7 Autovinç me kapacitetmbajtës minimum 50 ton | 1 copë | Pronësi ose me qera | |
| 8 Autovinç me kosh me kapacitet mbartes minimal 1 ton | 1 copë | Pronësi ose me qera | |
| 9 AutopompëBetonit | 1 copë | Pronësi ose me qera | |
| 10 Autobetonierë | 2 copë | Pronësi ose me qera | |
| 11 Mjetpër transport kapacitetmbajtës jo mëpak se 35 ton (Dampera teknologjike) | 2 copë | Pronësi ose me qera | |
| 12 Sondë për pilota thellesia minimum 10 m jo me pak se 80 ton .(Diametri sipasspecifikmevetezerit) | 1 copë | Pronësi ose me qera | |
| 13 Kokëterheqese | 1 copë | Pronësi ose me qera | |
| 14 Rimorkiatorpeshëmbajtëse jo mëpak se 45 ton | 1 copë | Pronësi ose me qera | |
| 15 Pompësuvatimi | 1 copë | Pronësi ose me qera | |
| 16 Depozitë uji jo mëpak se 5000 l | 1 copë | Pronësi ose me qera | |
| 17 Helikopternivellues | 1 copë | Pronësi ose me qera | |
| 18 Skeleri min 1500 m2 | | Pronësi ose me qera | |
| 19 Autobetoniere kantieri (Mjete Teknologjik) 2.5 m³-3 m³ | 2 copë | Pronësi ose me qera | |
| 20 Instrument per punimegjeodezike | 1 copë | Pronësi ose me qera | |
| 21 FabrikeBetonit | 1 copë | Pronësi me qeraose me kontratë furnizimi / jo mëlarg se 20 km nga objekti | |
| 22 Eskavator me pincë (Tranxhë Hidraulike) jo me pak se 30 ton | 1 copë | Pronësi ose me qera | |
| 23 Kontenier Stacioner (zyra, ndrrresa) | 1 copë | Pronësi ose me qera | |
| 24 Kompletindihmes se shpejte | 1 copë | Pronësi ose me qera | |
| 25 Kokore | 50 copë | Pronësi ose me qera | |
| 26 Fikesezjarri te levizshme me kapacitet 5-7 litra | 10 copë | Pronësi ose me qera | |
| 27 Prozhektorendriçiminaten | 10 copë | Pronësi ose me qera | |
| 28 Tabela paralajmeruese per sigurimin e perimetrit kantier | 12 copë | Pronësi ose me qera | |

1. Per mjetet qe shenohen ne rregjistra publike duhet te paraqitet dokument qe verteton pronesine e mjetit (certifikate pronesie), dokument që verteton rregjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), Certifikata e Kontrollit Teknik SGS si dhe Siguracionin e Mjetit (Polica e Sigurimit); te vlefshme. Per mjetet e siguruar me qera,te paraqiten dokumentet qe vertetojne Rregjistrimin e tij, plus Certifikaten e Kontrollit Teknik (SGS) dhe siguracionin e mjetit te vlefshme. Keto dokumente duhet te shoqerohen me Kontraten perkatese te qerases / furnizimit, e vlefshme kjo per te gjithë periudhen e realizimit te kontrates objekt i ketij prokurimi. Per mjetet dhe pajisjet e tjera qe nuk jane te shenuara ne rregjistra publike duhet te paraqitet kontrate noteriale e blerjes /fature tatimore / dokument zhdoganimi te mjetit .

2. Per pajisjet ne pronesi shoqerohen me akt pronesie origjinal ose fotokopje te noterizuar (kontrata shit blerje, kontrata dhurimi, fatura tatimore shitje, deklarate zhdoganimi) te vlefshme.

3. Për të konfirmuar disponibilitetin e mjeteve të marra me qira të paraqiten kontratë noteriale qiraje/huapërdorje me emër objekti dhe me afat të përcaktuar të cilat do të jenë në dispozicion deri në realizimin e punimeve; dhe/ose kontratë noteriale qiraje/huapërdorje pa afat të përcaktuar por të jenë të shoqëruara detyrimisht me mandat pagesat sipas parashikimit ligjor për secilin nga automjetet dhe/ose makineritë/pajisjet e marra me qira (me përjashtim të rasteve kur kontrata e qerases l fillon efektet në një moment të dytë pas zhvillimit të procedurës së prokurimit)

4. Për Impiantin e Betonit QKL me kodin III.1.B dhe Aktin e Miratimit Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotesimin e formularit sipas shtojcës 8 të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqiten në rastin kur OE shpallet fitues, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

Ne plotesim te kriterëve te mesiperme shoqeria SALILLARI ka plotesuar Formularin e Vetedeklarimit dhe ka deshmuar nepermjet dorezimit te dokumentacionit fizik Leje QARKULLIMI , Certifikaten e Kontrollit Teknik (SGS) dhe siguracionin e mjetit te vlefshme , mjetet si me poshte :

Në pronësi				
Lloji i Mjetit	Targa	Nr. Lejes qarkullimit	Nr. Shasisë	Të tjera
Kamion vetshkarkues me kapacitet	BR 5216 A	256377	WDB62413715120000	
Mercedes				
mbajtes 8 -10 ton	AA217PR	BRD0102717	WDB9525361K957029	Mercedes
3 copë	AA576RY	BRD0427617	WDB9505621L057261	Mercedes

Mjetet e paraqitura nga Shoqëria Salillari- Kamion vetshkarkues me kapacitet mbajtes 8 -10 ton , referuar Dokumentacionit Teknik -Lejes se Qarkullimit kane nje tonazh si me poshte vijon :

Kamion vetshkarkues me kapacitet	BR 5216 A	10300 kg - 10ton
mbajtes 8 -10 ton	AA217PR	10500 kg — 10ton
AA576RY	8550kg — 8 ton	

Pra , qendrimi dhe arsyeja e skualifikimit ne lidhje me tonazhin e mjeteve te Kamion vetshkarkues me kapacitet mbajtes 8 -10 ton nuk qendron pasi Operatori Ekonomik Salillari shpk nga dy Kamion vetshkarkues qe jane kerkuar ka paraqitur tre Kamjona Veteshkarkues

Nga te dhenat e paraqitura rezulton se e tre kamjonat e deklaruar dhe te paraqitura me dokumentacion provues prane AK nuk e kalojne kapacitetin mbajtes 10 ton .Per sa me siper arsyet Autoritetit Kontraktor nuk qendrojne .

Ne lidhje me konstatimin tjeter te Autoritetit Kontraktor se shoqëria Salillari nuk ploteson piken 11 te kriterit 2.3.9 te kapacitetit teknik paisje dhe mjete sepse mjetet me targe AB 233 OB, dhe AB 247 OB, e kane kapacitetin mbajtes me pak se 35 ton, me konkretisht 24 ton dhe 28 ton. 3-Damperat Cat model 771D sipas fatures 217 date 20.06.2012, dhe fatures 205 date 07.06.2012, nuk jane te pajisur me leje qarkullimi, certificate e kontrollit teknik te mjeteve rugore, si dhe police per sigurimin e detyrueshem te mbatesve te mjeteve motorike.4.Mjetet e paraqitura me targe AA 254 TE, dhe ABR 342 janë kamion me rimorkio, jo dampera. Mjetet me targe AA 398 SU dhe ADR 805 jane trajle, jo dampera.

Operatori Ekonomik per te deshmuar se disponon Mjete per transport me kapacitet mbajtes jo me pak se 35 ton (Dampera teknologjik) 2 cope , ka paraqitur mjete transport me shume se numri i kerkuar nga Autoriteti Kontraktor.

Konkretisht ne Formularin e vetdeklarimit jane paraqitur Mjet për transport -Dampera sipas listes me poshte :

Në pronësi			
Lloji i Mjetit	Targa	Nr. Lejes qarkullimit	Nr. Shasisë Të tjera
Mjet për transport kapacitete	AB247OB	BRD00326524	VCEOA25EP00013912
Volvo			
mbajtës jo më pak se 35 ton	AB233OB	BRD00326724	VCEOA30EC00012468
Volvo			
(Dampera teknologjike)	217 6YS00427	CAT	
205 6YS00261	CAT		
AA254TE			
ABR 342	BRD0020618		
TRDA4032212	WDB9340321L318284		
ZA9S47GP00K32001	Mercedes		
AA398SU			
ADR 805	BRD0020318		
TRDA 1534516	WDB9340331L411255		
ZA9ALTAROM2G62066	Mercedes		

Mjetet e mesiperme kane respektivisht tonazhin si me poshte:

Mjet për transport kapacitete	AB247OB	Volvo (28 Ton)
mbajtës jo më pak se 35 ton	AB233OB	Volvo (24 ton)
(Dampera teknologjike)	Cat model 771D	40950 kg
Cat model 771D	40950 kg	
AA254TE		
ABR 342	Mercedes	
39240 kg		
AA398SU		
ADR 805	Mercedes	
39600 kg		

Shoqëria ka paraqitur mjete me targa konkretisht Mjeti me targe AB 247 OB dhe Mjeti me Targe AB 233 OB per te cilen ka paraqitur te gjithë dokumentacionin e kerkuar ne DST.

Perveç mejteve te mesiperme ka paraqitura edhe mjetet Damperat Cat model 771D (2 cope) me Fature Tatimore Shitje nr 217 date 20.06.2012, dhe fatures 205 date 07.06.2012 dhe fotot perkatese. Sipas modelit keto mjet kane nje kapacitet mbajtes 40950 kg.

Ndryshe nga cfare pretendon Autoriteti Kontraktor keto mjete nuk kane nevojë qe te pajisen me leje qarkullimi dhe per kete arsye nuk pajisen as me Akt kolaudimi dhe as me siguracion .Keto jane mjete teknologjike qe qarkullojne ne kantier dhe qe nuk levizin ne rruge .

Në nenin 47 "Përkufizime" pika 2/c, nenin 58 "Makinat teknologjike" dhe në nenin 113 "Qarkullimi në rrugë i makinave teknologjike" të ligjit nr. 8378, datë 22.07.1998 "KODI RRUGOR I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË", i ndryshuar parashikohet se:

Neni 58

Makinat teknologjike

1. Makinat teknologjike janë makina vetëlëvizëse ose që tërhiqen, me rrota ose me zinxhirë. Këto makina janë të destinuara të operojnë mbi rrugë dhe në kantiere dhe mund të jenë të pajisura me mekanizma specialë. Këto mjete mund të lëvizin në rrugë për të kaluar nga një vend pune në tjetrin ose për të zhvendosur sende që lidhen me ciklin e punës së vetë makinës ose të kantierit, sipas kufizimeve dhe mënyrave të përcaktuara nga aktet në zbatim.

2. Sipas qëllimeve të qarkullimit rrugor, makinat teknologjike ndahen në:
- a) makina që përdoren për ndërtimin dhe mirëmbajtjen e veprave ndërtimore a të infrastrukturës rrugore ose për rivendosjen e trafikut;
 - b) makina që zhblokojnë rrugën nga bora ose ndihmëse që shpërndajnë rërë a gjëra të këtij lloji;
 - c) motopirunët dhe elektropirunët: mjete të destinuara për lëvizjen e sendeve.
3. Makinat teknologjike vetëlëvizëse, sipas karakteristikave që kanë, mund të kenë jo më shumë se tri ndenjësë për personelin e shërbimit, duke përfshirë edhe drejtuesin e tyre.
4. Për t'iu përshtatur qarkullimit rrugor, këto makina nuk duhet të jenë të afta ta kalojnë shpejtësinë 40 km/h, kur lëvizin në rrugë horizontale, kurse makinat teknologjike vetëlëvizëse me rrota jopneumatike a me zinxhirë nuk duhet të jenë të afta ta kalojnë shpejtësinë 15 km/h, kur lëvizin në rrugë horizontale

Neni 113

Qarkullimi në rrugë i makinave teknologjike

1. Për të qarkulluar në rrugë makinat teknologjike duhen respektuar përmasat gabaritë kufitare dhe peshat kufitare të përcaktuara në nenet 61 dhe 62, kurse për normat konstruktive dhe sistemet e pajimit duhet të respektojnë dispozitat e nenit 105.
2. Për të qarkulluar në rrugë makinat teknologjike duhen regjistruar në zyrat e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor, që i lëshojnë lejen e qarkullimit atij që vërteton se është pronari i mjetit.
3. Për të qarkulluar në rrugë makinat teknologjike duhen respektuar dispozitat e neneve 98, 106, 107, 110 dhe 111. Makinat teknologjike që, për kërkesa funksionale, i tejkalojnë përmasat gabaritë kufitare dhe peshat kufitare të përcaktuara në nenet 61 dhe 62, konsiderohen makina teknologjike jashtë norme dhe për to zbatohen normat e parashikuara në nenin 103, pika 8.
4. Për të qarkulluar në rrugë makinat teknologjike vetëlëvizëse dhe ato që tërhiqen, duhet të jenë të pajisura me një targë njohjeje, e cila përmban të dhënat e regjistrimit.
5. Mënyrat e zbatimit të pikave 2 dhe 3, si dhe ato që kanë të bëjnë me modifikimet në emërtimin e mjeteve, përmbajtjen dhe karakteristikat e lejes së qarkullimit, janë përcaktuar me udhëzime të organeve të ministrisë përgjegjëse për transportin.
6. Mënyrat për regjistrimin dhe targimin përcaktohen në akte të veçanta.
7. Cilido që shkel dispozitat e këtij neni, ndëshkohet me të njëjtat sanksione të parashikuara për të njëjtat shkelje të kryera me makinat bujqësore.

Përcaktimet e nenit 58, të ligjit nr. 8378, datë 22.07.1998 "KODI RRUGOR I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË", i ndryshuar, përcaktohet se cilat janë mjete që klasifikohen si "mjete teknologjike" dhe fakti që këto mjete janë me goma jo domosdoshmërisht përcakton dhe detyrimin që të pajisen me targa, ndërkohë që në interpretim të përcaktimeve të nenit 113 të ligjit nr. 8378, datë 22.07.1998 "KODI RRUGOR I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË", i ndryshuar, të gjitha kategoritë e mjeteve (të përcaktuara në nenin 47 të të ligjit nr. 8378, datë 22.07.1998 "KODI RRUGOR I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË", i ndryshuar) përfshirë dhe mjetet teknologjike në momentin kur qarkulloj në rrugë duhet të jenë të pajisur me targa, ndërsa në rastin kur lëvizin vetëm në kantier atëherë nuk kanë detyrim që të pajisen me targa.

Gjithashtu për plotesimin e pikes 11 të kriterit 2.3.9 O E ka paraqitur edhe mjete transporti me kapacitet mbi 39 ton (mjeti me targe AA254TE, ABR 342) dhe (mjeti me targe AA398SU, ADR 805) vertetuar me dokumentacionin e vlefshëm të dorëzuar pranë Autoritetit Kontraktor.

Në lidhje me sa me sipër shoqëria Salillari shpk ploteson kriteret e përcaktuar në DST pika 4, 11 të kriterit 2.3.9 Kapaciteti Teknik mjete dhe pajisje

"Përveç të gjitha arsyeve të përmendura më sipër, sjellim në vëmendje se Autoriteti Kontraktor ka pasur mundësinë dhe të drejtën ligjore, në përputhje Ligjin nr. 162/2020 'Për Prokurimin Publik', të kërkojë në çdo kohë sqarime ose dokumentacion shtesë nga operatori ekonomik lidhur me kapacitetet teknike ose profesionale të paraqitura prej tij, përpara publikimit të vendimit të vlerësimit/Klasifikimit.

Për sa me sipër duke e gjetur vendimin për skualifikim të shoqërisë Salillari shpk në kundërshtim me Dokumentat e Tenderit, me parimet e Ligjit për Prokurimin Publik dhe legjislacionin në fuqi kërkojmë shfryqëzimin e vendimit të Autoritetit Kontraktor dhe kualifikimin e shoqërisë Salillari në procedurën "Ndërtimi i Godines së Bashkise"

II.19. Në përputhje me nenin 112 "Veprimet paraprake" të Ligjit nr.162/2020 "Për Prokurimin Publik", Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe me anë të formularit të publikimit nr. 1725/1 prot., datë 02.07.2025 janë

publikuar arsyet e skualifikimit të cilat operatori ekonomik ankimues “Salillari” SHPK, kundërshton nëpërmjetë ankesës nr. 1725/2025, datë 01.07.2025.

II.20. Më datë 15.07.2025 nëpërmjetë postës elektronike zyrtare pranë Komisionit Prokurimit Publik nga ana e autoritetit kontraktor është dërguar shkresa nr. 2043/2 prot, datës 15.07.2025, protokolluar me tonën me nr. 1725/2 prot., datë 30.07.2025, me objekt “Kthim përgjigje ankesës A/2025/5050, datë 01.07.2025, autoriteti kontraktor ka dërguar aktin e trajtimit të ankesës nga verifikimi i të cilit rezulton se ka vendosur mos pranimin ankesës nr. 1725/2025, datë 01.07.2025, të operatorit ekonomik ankimues “Salillari” SHPK.

II.21. Me qëllim shqyrtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues, me anë të shkresës nr. 1725/3 prot., datë 30.07.2025, Komisioni i Prokurimit Publik i ka kërkuar autoritetit kontraktor që të dërgojë pranë KPP-së dokumentacion e dorëzuar nga operatori ekonomik “Salillari” SHPK pranë autoritetit kontraktor në përmbushje të nenit 26 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

II.22. Më datë 31.07.2025 nëpërmjetë postës elektronike zyrtare pranë Komisionit Prokurimit Publik nga ana e autoritetit kontraktor është dërguar informacion dhe dokumentacion në zbatim të kërkesës së sipërcituar, protokolluar me tonën me nr. 1725/4 prot., datë 31.07.2025.

II.23. Me qëllim shqyrtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues, me anë të shkresës nr. 1725/5 prot., datë 05.08.2025, Komisioni i Prokurimit Publik i ka rikërkuar autoritetit kontraktor që të dërgojë pranë KPP-së dokumentacion e dorëzuar nga operatori ekonomik “Salillari” SHPK pranë autoritetit kontraktor në përmbushje të nenit 26 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

II.24. Me shkresën nr. 2043/9 prot, datës 01.08.2025, me objekt “*Dërgim dokumentacioni lidhur me ankesën e operatorit ekonomik “Salillari” SHPK – Ref-31297-11-27-2024*” protokolluar me tonën me nr. 1725/6 prot., datë 06.08.2025, autoriteti kontraktor ka depozituar informacion dhe dokumentacion pranë Komisionit të Prokurimit Publik në zbatim të shkresës 1725/5 prot, datë 05.08.2025.

II.25. Me shkresën nr. 2346/1 prot, datës 08.08.2025, me objekt “*Përgjigje në lidhje me dërgimin e informacionit dhe dokumentacionit për shqyrtimin e ankesës së operatorit ekonomik “Salillari” SHPK*” protokolluar me tonën me nr. 1725/7 prot., datë 11.08.2025, autoriteti kontraktor ka depozituar informacion dhe dokumentacion pranë Komisionit të Prokurimit Publik në zbatim të shkresës 1725/5 prot, datë 05.08.2025.

II.26. Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosjen e shqyrtimit administrativ, si dhe bazuar në informacionin e Autoritetit Kontraktor, u konstatua se nuk ka pasur pretendime nga subjekte të interesuara, në përputhje me nenin 113 të ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”.

III Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor dhe verifikimeve të kryera,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Salillari” SHPK, mbi kundërshtimin e skualifikimit të ofertës së tij, me argumentimin se: *Operatori nuk ploteson nen piken 4 të pikës 2.3.9 Kapaciteti teknik Paisje e mjete: 1.1 Kapaciteti mbajtes i mjetit BR 5216 A është 10.3 ton; 1.2 Kapaciteti mbajtes i mjetit AA 217 PR është 10.5 ton. Këto mjete nuk kanë tonazhin e përcaktuar nga Autoriteti Kontraktor, pasi kapaciteti mbajtës i tyre duhet të jetë nga 8 ton deri në 10 ton, ndërkohë që këto dy mjete e kanë tonazhin më të madh se 5 deri në 10 ton, dhe me konkretisht 10.3 ton dhe 10.5 ton , duke mosplotësuar kërkesën për tonazhin e mjeteve. 2- Nuk plotësohet nenpika 11 e pikës 2.3.9 Kapaciteti teknik Paisje e mjete, sepse mjetet me targë AB 233 OB, dhe AB 247 OB, e kanë kapacitetin mbajtes me pak se 35 ton, me konkretisht 24 ton dhe 28 ton. 3-Damperat Cat model 771D sipas fatures 217 datë 20.06.2012, dhe fatures 205 datë 07.06.2012, nuk janë të pajisur me leje qarkullimi, certifikate e kontrollit teknik të mjeteve rrugore, si dhe police për sigurimin e detyrueshem të mbajtesve të mjeteve motorike. 4- Mjetet e paraqitura me targë AA 254 TE, dhe ABR 342 janë kamion me rimorkio, jo dampera. 5- Mjetet me targë AA 398 SU dhe ADR 805 janë trajle, jo dampera”, Komisioni i Prokurimit Publik, vëren se:*

III.1.1. Në shtojcën 7/2 “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, pika 2.3.9 “Kapaciteti teknik”, të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt – ankimi të modifikuara, të publikuara nga autoriteti kontraktor në SPE, është parashikuar plotësimi i kriterit si më poshtë vijon:

Disponimi ose mundësia e sigurt e disponimit në paisjet/kapacitete të mëposhtme teknike, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës:

	Pershkrimi i Automjetit	Sasia	Gjendja
1	Eskavator me goma 0.25m3 (MT)	2 copë	Pronësi ose me qera
2	Fadroma	2 copë	Pronësi ose me qera
3	Kamionëveteshkarkues me kapacitetmbajtës 10 - 20 Ton	2 copë	Pronësi ose me qera
4	Kamion vetshkarkues me kapacitetmbajtes 8 -10 ton	2 copë	Pronësi ose me qera

5	Kamioncine me kapacitetmbajtes 3.5-5 ton	2 copë	Pronësi ose me qera
6	Kamioncine me kapacitetmbajtes 1-3 ton	2 copë	Pronësi ose me qera
7	Autovinç me kapacitetmbajtës minimum 50 ton	1 copë	Pronësi ose me qera
8	Autovinç me kosh me kapacitet mbartes minimal 1 ton	1 copë	Pronësi ose me qera
9	AutopompëBetoni	1 copë	Pronësi ose me qera
10	Autobetonierë	2 copë	Pronësi ose me qera
11	Mjetpër transport kapacitetmbajtës jo mëpak se 35 ton (Dampera teknologjike)	2 copë	Pronësi ose me qera
12	Sondëpërpilotathellesia minimum 10 m jo me pak se 80 ton .(Diametri sipasspecifikmevetezerit)	1 copë	Pronësi ose me qera
13	Kokëterheqese	1 copë	Pronësi ose me qera
14	Rimorkiatorpeshëmbajtëse jo mëpak se 45 ton	1 copë	Pronësi ose me qera
15	Pompësuvatimi	1 copë	Pronësi ose me qera
16	Depozitë uji jo mëpak se 5000 l	1 copë	Pronësi ose me qera
17	Helikopternivelues	1 copë	Pronësi ose me qera
18	Skeleri	min 1500 m ²	Pronësi ose me qera
19	Autobetoniere kantieri (Mjete Teknologjik) 2.5 m ³ -3 m ³	2 copë	Pronësi ose me qera
20	Instrument per punimegjeodezike	1 copë	Pronësi ose me qera

21	Fabrike Betoni	1 copë	Pronësi me qera ose me kontratë furnizimi/ jo më larg se 20 km nga objekti
22	Eskavator me pincë (Tranxhë Hidraulike) jo me pak se 30 ton	1 copë	Pronësi ose me qera
23	Kontenier Stacioner (zyra, ndrrresa)	1 copë	Pronësi ose me qera
24	Kompletindihmes se shpejte	1 copë	Pronësi ose me qera
25	Kokore	50 copë	Pronësi ose me qera
26	Fikesezjarri te levizshme me kapacitet 5-7 litra	10 copë	Pronësi ose me qera
27	Prozhektorendriçiminaten	10 copë	Pronësi ose me qera
28	Tabela paralajmeruese per sigurimin e perimetrit kantier	12 copë	Pronësi ose me qera

1. Per mjetet qe shenohen ne rregjistra publike duhet te paraqitet dokument qe verteton pronesine e mjetit (certifikate pronesie), dokument qe verteton rregjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), Certifikata e Kontrollit Teknik SGS si dhe Siguracionin e Mjetit (Polica e Sigurimit); te vlefshme. Per mjetet e siguruara me qera, te paraqiten dokumentet qe vertetojne Rregjistrimin e tij, plus Certifikaten e Kontrollit Teknik (SGS) dhe siguracionin e mjetit te vlefshme. Keto dokumente duhet te shoqerohen me Kontraten perkatese te qerases / furnizimit, e vlefshme kjo per te gjithë periudhen e realizimit te kontrates objekt i ketij prokurimi. Per mjetet dhe pajisjet e tjera qe nuk jane te shenuara ne rregjistra publike duhet te paraqitet kontrate noteriale e blerjes /fature tatimore / dokument zhdoganimit te mjetit .
2. Per pajisjet ne pronesi shoqerohen me akt pronesie original ose fotokopje te noterizuar (kontrata shit blerje, kontrata dhurimi, fatura tatimore shitje, deklarate zhdoganimit) te vlefshme.
3. Për të konfirmuar disponibilitetin e mjeteve të marra me qira të paraqiten kontratë noteriale qiraje/huapërdorje me emër objekti dhe me afat të përcaktuar të cilat do të jenë në dispozicion deri në realizimin e punimeve; dhe/ose kontratë noteriale

qiraje/huapërdorje pa afat të përcaktuar por të jenë të shoqëruara detyrimisht me mandat pagesat sipas parashikimit ligjor për secilin nga automjetet dhe/ose makineritë/pajisjet e marra me qira (me perjashtim të rasteve kur kontrata e qerash fillon efektet në një moment të dytë pas zhvillimit të procedurës së prokurimit)

4. Për Impiantin e Betonit QKL me kodin III.1.B dhe Aktin e Miratimit

Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 8 të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqiten në rastin kur OE shpallet fitues, ose nëse kërkojnë sqarime nga autoriteti kontraktor.

III.1.2. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike si dhe nga informacioni i dërguar nga ana e autoritetit kontraktor rezulton, se operatori ekonomik “Salillari” SHPK, në përmbushje të kriterit sa më sipër, ka dorëzuar:

- Formular Përmbledhës Vetëdeklarimi nga operatori ekonomik “Salillari” SHPK, me datë 26.12.2025.
- Dokumentacionin fizik i njehësuar me origjinalin i mjeteve që disponon në përmbushje të kriterit 2.3.9 të DT, të dërguar nga autoriteti kontraktor me shkresën nr. 2043/9 prot, datë 01.08.2025, me anë të të cilit citon se bashkalidhur kësaj shkrese, po ju dërgojmë kopje të njehësuar me origjinalin të dokumentave të paraqitura nga operatori ekonomik Salillari shpk, kopje e formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, dhe vërtetimet për disponimin e mjeteve dhe makinerive.

III.1.3. Në nenin 2 “Qëllimi i ligjit” të ligjit nr. 162/2021 “Për prokurimin publik” parashikohet se: Qëllim i këtij ligji është:

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.

III.1.4. Në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit nr. 162/2021 “Për prokurimin publik” parashikohet se:

1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.
2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.
3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.

III.1.5. Në nenin 21, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, thuhet shprehimisht: “1. Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj. Në kuptim të kësaj pike, autoriteti ose enti kontraktor ka detyrimin të mirëplanifikojë në cilësi dhe në kohë fondet publike e nevojat e tij dhe të prokurojë e të zbatojë kontratën në përputhje me legjislacionin në fuqi.”

III.1.6. Në nenin 77, pikat 1 dhe 3 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet se: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionale ose tregtarë. Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.

3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.

Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

Xhironja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.

Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë.

Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme

njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”

Neni 92 pika 4 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, parashikohet se: 23 *“Oferta konsiderohet e vlefshme edhe nëse ajo përmban devijime të vogla, të cilat nuk ndryshojnë thelbësisht karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, gabime shtypi, të cilat mund të korrigjohen pa prekur përmbajtjen e saj, si edhe ato të lidhura me informacionet që merren lehtësisht nga dokumente faktike, që tregojnë gjendjen e operatorit ekonomik në kohën e ofertimit”.*

III.1.7. Neni 39 “Kërkesa të veçanta për kontratat për punë publike”, të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikon shprehimisht se:

“4. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.

6. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

a) licenca profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe/ose

b) që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë, kur një gjë e tillë është e detyrueshme nga legjislacioni përkatës; dhe/ose

c) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose

ç) fuqinë minimale punëtore të operatorit ekonomik, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose

d) mjetet e pajisjet teknike, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën”.

III.1.8. Në nenin 82 “*Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit*” pika 1 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht : “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik.”

Ndërsa në nenin 92/3 të LPP-së përcaktohet: “3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...”

III.1.9. Në nenin 26 “*Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit*” të Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet se:

“1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.

2. Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit përmban informacion dhe deklarimin, si më poshtë vijon:

a) operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin ose sipas legjislacionit të posaçëm, në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;

b) operatori ekonomik nuk është dënuar për asnjë nga veprat penale, të parashikuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;

c) personi/at në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose që ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, nuk është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;

ç) operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale;

d) operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi;

dh) operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e taksave dhe tatimeve 1 të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 76, të LPP-së;

e) operatori ekonomik ka shlyer të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike, dhe përmbush kërkesat që rrjedhin nga legjislacioni i fushës në fuqi. Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët ushtrojnë veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë;

ë) operatori ekonomik nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;

f) operatori ekonomik ushtron aktivitetin në zbatim të kërkesave ligjore të legjislacionit mjedisor, social dhe të punës;

- g) operatori ekonomik ka paraqitur ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- gj) operatori ekonomik përmbush specifikimet teknike, sipas kërkesave të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor;
- h) operatori ekonomik disponon fuqinë punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor (kur është rasti);
- i) operatori ekonomik disponon mjetet dhe makineritë e nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor, kur është rasti;
- j) informacion mbi subjektet, mbi kapacitetet e të cilave, operatori ekonomik do të mbështetet, nëse është rasti dhe nënkontraktorët e mundshëm, nëse është rasti;
- k) operatori ekonomik ushtron aktivitetin konform kërkesave të legjislacionit në fuqi.
3. Informacioni i pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në një bazë të dhënash, ku autoriteti/enti kontraktor mund të aksesojë direkt këtë informacion dhe /ose dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash.
4. Për përmbushjen e detyrimit sipas këtij neni, operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm.
5. Operatorëve ekonomikë nuk u kërkohet të dorëzojnë dokumente mbështetëse, kur autoriteti ose enti kontraktor që ka dhënë kontratën ose ka lidhur marrëveshjen kuadër, i ka këto dokumente.
6. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të nenit 26 të V, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin. Autoriteti/enti kontraktor pranon një dokument të lëshuar nga i njëjti institucion ose palë e tretë dhe që ka të njëjtin informacion me atë të paraqitur në procedurën e zhvilluar në mënyrë elektronike.
- Operatorët ekonomikë të huaj duhet të paraqesin dokumentet në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit të lëshuar në një shtet të huaj.
- Për dokumentet që nuk lëshohen në vendin e origjinës, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë këtë fakt, përndryshe dokumentacioni do të konsiderohet i paparaqitur.
7. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.”

III.1.10. Në nenin 47 “Klasifikimi i mjeteve rrugore” të ligjit nr. 8378, datë 22.07.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar parashikohet se:

1. Mjetet, sipas qëllimeve të përcaktuara në këtë Kod, klasifikohen si vijon:

- a) mjete që lëvizin me forcën e krahut;
- b) mjete të tërhequra me kafshë;
- c) mjete me pedal;
- d) slita;
- e) ciklomotori;

- f) motomjete;
- g) automjete;
- h) trolejbusë;
- i) rimorkio;
- j) makina bujqësore;
- k) makina teknologjike;
- l) mjete rrugore të veçanta.

2. Mjete me motor dhe rimorkiot e tyre, sipas shkronjave “e”, “f”, “g”, “h”, “i” “j” dhe “l”, të pikës 1, të këtij neni, klasifikohen, gjithashtu, në bazë të kategorive ndërkombëtare si më poshtë:

a) - *Kategoria L1: mjete me dy rrota, cilindrata e motorit (kur flitet për motor me djegie të brendshme) të mos i kalojë 50 cm³ dhe me shpejtësi maksimale të projektuar (për çdo lloj sistemi motorik) jo më të madhe se 45 km/h, fuqia maksimale nuk është më shumë se 4 kW në rastin e një motori elektrik;*

- *Kategoria L2: mjete me tri rrota, cilindrata e motorit (kur flitet për motor me djegie të brendshme) të mos i kalojë 50 cm³ dhe me shpejtësi maksimale të projektuar (për çdo lloj sistemi motorik) jo më të madhe se 45 km/h; rendimenti maksimal neto i fuqisë nuk është më shumë se 4 kW, në rastin e motorëve të tjerë me djegie të brendshme, ose fuqia maksimale e vazhdueshme nuk është më shumë se 4 kW, në rastin e një motori elektrik;*

- *Kategoria L3: mjete me dy rrota, pa kosh, cilindrata e motorit (kur flitet për motor me djegie të brendshme) është më e madhe se 50 cm³ dhe me shpejtësi maksimale të projektuar (për çdo lloj sistemi motorik) më të madhe se 45 km/h;*

- *Kategoria L4: mjete me dy rrota, me kosh, cilindrata e motorit (kur flitet për motor me djegie të brendshme) është më e madhe se 50 cm³ dhe me shpejtësi maksimale të projektuar (për çdo lloj sistemi motorik) më të madhe se 45 km/h;*

- *Kategoria L5: mjete me tri rrota të përshtatura simetrikisht, cilindrata e motorit (kur flitet për motor me djegie të brendshme) është më e madhe se 50 cm³ dhe me shpejtësi maksimale të projektuar (për çdo lloj sistemi motorik) më të madhe se 45 km/h;*

- *Kategoria L6: mjete me katër rrota të lehta, masa e pangarkuar e të cilave nuk është më shumë se 350 kg, pa përfshirë masën e baterive në rastin e automjeteve elektrike, me shpejtësi maksimale të projektuar jo më të madhe se 45 km/h, cilindrata e motorit të mos i kalojë 50 cm³ dhe rendimenti maksimal neto i të cilëve nuk është më shumë se 4 kW, në rastin e motorëve të tjerë me djegie të brendshme, ose fuqia maksimale e vazhdueshme e të cilëve nuk është më shumë se 4 kW, në rastin e një motori elektrik;*

- *Kategoria L7: mjete me katër rrota të ndryshme nga L6, masa e pangarkuar e të cilave nuk është më shumë se 400 kg (550 kg për automjetet e synuara për transportimin e mallrave), pa përfshirë masën e baterive, në rastin e automjeteve elektrike, dhe fuqia maksimale neto e motorit e të cilave nuk është më shumë se 15 kW;*

b) - *kategoria M: mjete me motor të destinuara për transport njerëzish dhe që kanë të paktën katër rrota;*

- *kategoria M1: mjete të destinuara për transport njerëzish dhe që nuk kanë më shumë se tetë ndenjëse, përveç ndenjësës së drejtuesit të mjetit;*

- *kategoria M2: mjete të destinuara për transport njerëzish dhe që kanë më shumë se tetë ndenjëse, përveç ndenjësës së drejtuesit të mjetit dhe peshë maksimale me ngarkesë deri 5 tonë;*

- *kategoria M3: mjete të destinuara për transport njerëzish dhe që kanë më shumë se tetë ndenjëse, përveç ndenjësës së drejtuesit të mjetit dhe peshë maksimale me ngarkesë më të madhe se 5 tonë;*

c) - *kategoria N: mjete me motor të destinuara për transport mallrash dhe që kanë të paktën katër rrota;*

- *kategoria N1: mjete të destinuara për transport mallrash dhe që kanë peshë maksimale me ngarkesë jo më të madhe se 3,5 tonë;*

- *kategoria N2: mjete të destinuara për transport mallrash, me peshë maksimale me ngarkesë më të madhe se 3,5 tonë, por jo më të madhe se 12 tonë;*

- *kategoria N3: mjete të destinuara për transport mallrash, me peshë maksimale me ngarkesë më të madhe se 12 tonë;*

d) - *kategoria O: rimorkiot (përfshirë edhe gjysmërimorkiot);*

- *kategoria O1: rimorkio me peshë maksimale me ngarkesë jo më të madhe se 0,75 tonë,*

- *kategoria O2: rimorkio me peshë maksimale me ngarkesë më të madhe se 0,75 tonë, por jo më të madhe se 3,5 tonë;*

- *kategoria O3: rimorkio me peshë maksimale me ngarkesë më të madhe se 3,5 tonë, por jo më të madhe se 10 tonë;*

- *kategoria O4: rimorkio me peshë maksimale me ngarkesë më të madhe se 10 tonë.*

dh) - *Kategoria T: traktorët me rrota;*

- *Kategoria T1: traktorët me rrota, me shpejtësi maksimale në kushte sigurie prej jo më shumë se 40 km/h, me boshtin më të afërt te drejtuesi, që ka gjerësi minimale zinxhiri prej jo më pak se 1150 mm, me një masë të pangarkuar në rend të njëpasnjëshëm prej më shumë se 600 kg dhe me lartësi nga toka prej jo më shumë se 1 000 mm;*

- *Kategoria T2: traktorët me rrota, me shpejtësi maksimale në kushte sigurie prej jo më shumë se 40 km/h, me gjerësi minimale zinxhiri prej më pak se 1150 mm, e një masë të pangarkuar në rend të njëpasnjëshëm prej më shumë se 600 kg dhe me lartësi nga toka prej jo më shumë se 600 mm;*

- *Kategoria T3: traktorët e pajisur me rrota, me shpejtësi maksimale në kushte sigurie prej jo më shumë se 40 km/h dhe me një masë të pangarkuar në rend të njëpasnjëshëm prej jo më shumë se 600 kg;*

- *Kategoria T4: traktorët e pajisur me rrota për qëllime të veçanta, me shpejtësi maksimale në kushte sigurie prej jo më shumë se 40 km/h;*

- *Kategoria T5: traktorët e pajisur me rrota me shpejtësi maksimale në kushte sigurie prej jo më shumë se 40 km/h;*

- *Kategoria C: traktorët me zinxhirë të pandërprerë;*

Traktorët me zinxhirë të pandërprerë që shtyhen dhe drejtohen nga zinxhirë të pandërprerë dhe kategoritë e të cilëve, C1 deri C5, përcaktohen në analogji me kategoritë T1 deri T5.

III.1.11. Në nenin 58 “Makinat teknologjike” të ligjit nr. 8378, datë 22.07.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar parashikohet se:

1. Makinat teknologjike janë makina vetëlëvizëse ose që tërhiqen, me rrota ose me zinxhirë. Këto makina janë të destinuara të operojnë mbi rrugë dhe në kantiere dhe mund të jenë të pajisura me mekanizma specialë. Këto mjete mund të lëvizin në rrugë për të kaluar nga një

vend pune në tjetrin ose për të zhvendosur sende që lidhen me ciklin e punës së vetë makinës ose të kantierit, sipas kufizimeve dhe mënyrave të përcaktuara nga aktet në zbatim.

2. Sipas qëllimeve të qarkullimit rrugor, makinat teknologjike ndahen në:

a) makina që përdoren për ndërtimin dhe mirëmbajtjen e veprave ndërtimore a të infrastrukturës rrugore ose për rivendosjen e trafikut;

b) makina që zhbllokojnë rrugën nga bora ose ndihmëse që shpërndajnë rërë a gjëra të këtij lloji;

c) motopirunët dhe elektropirunët: mjete të destinuara për lëvizjen e sendeve.

3. Makinat teknologjike vetëlëvizëse, sipas karakteristikave që kanë, mund të kenë jo më shumë se tri ndenjës për personelin e shërbimit, duke përfshirë edhe drejtuesin e tyre.

4. Për t'iu përshtatur qarkullimit rrugor, këto makina nuk duhet të jenë të afta ta kalojnë shpejtësinë 40 km/h, kur lëvizin në rrugë horizontale, kurse makinat teknologjike vetëlëvizëse me rrota jopneumatike a me zinxhirë nuk duhet të jenë të afta ta kalojnë shpejtësinë 15 km/h, kur lëvizin në rrugë horizontale.

III.1.12. Në nenin 113 “Qarkullimi në rrugë i makinave teknologjike” të ligjit nr. 8378, datë 22.07.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar parashikohet se:

1. Për të qarkulluar në rrugë makinat teknologjike duhen respektuar përmasat gabaritë kufitare dhe peshat kufitare të përcaktuara në nenet 61 dhe 62, kurse për normat konstruktive dhe sistemet e pajimit duhet të respektojnë dispozitat e nenit 105.

2. Për të qarkulluar në rrugë makinat teknologjike duhen regjistruar në zyrat e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor, që i lëshojnë lejen e qarkullimit atij që vërteton se është pronari i mjetit.

3. Për të qarkulluar në rrugë makinat teknologjike duhen respektuar dispozitat e neneve 98, 106, 107, 110 dhe 111. Makinat teknologjike që, për kërkesa funksionale, i tejkalojnë përmasat gabaritë kufitare dhe peshat kufitare të përcaktuara në nenet 61 dhe 62, konsiderohen makina teknologjike jashtë norme dhe për to zbatohen normat e parashikuara në nenin 103, pika 8.

4. Për të qarkulluar në rrugë makinat teknologjike vetëlëvizëse dhe ato që tërhiqen, duhet të jenë të pajisura me një targë njohjeje, e cila përmban të dhënat e regjistrimit.

5. Mënyrat e zbatimit të pikave 2 dhe 3, si dhe ato që kanë të bëjnë me modifikimet në emërtimin e mjeteve, përmbajtjen dhe karakteristikat e lejes së qarkullimit, janë përcaktuar me udhëzime të organeve të ministrisë përgjegjës për transportin.

6. Mënyrat për regjistrimin dhe targimin përcaktohen në akte të veçanta.

7. Cilido që shkel dispozitat e këtij neni, ndëshkohet me të njëjtat sanksione të parashikuara për të njëjtat shkelje të kryera me makinat bujqësore.

III.1.13. Në nenin 209 “Kufijtë dhe mënyrat e qarkullimit të makinave teknologjike” të VKM nr. 153, datë 07.04.2000 “Për Miratimin e Rregullores së Zbatimit të Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar parashikohet se:

1. Makinat teknologjike, për të cilat flitet në nenin 58 të Kodit Rrugor, mund të qarkullojnë në rrugë, në përputhje me rregullat e vendosura nga neni 113 i Kodit Rrugor.

2. Për rastin e pikës 1, makinat teknologjike mund të qarkullojnë me ose pa pajisjet e punës, të njohura nga qendra e miratimit apo homologimit si të çmontueshme, me kusht që për çdo rast të respektohen kufijtë e përmasave dhe e peshës së verifikuar nga kjo qendër, duke përfshirë këtu vlerën e raportit minimal ndërmjet peshës ose peshave që rëndojnë mbi aksin ose akset e përparme, dhe të asaj ose atyre, që rëndojnë mbi aksin ose akset e pasme.

3. Të gjitha hollësitë e përshkruara në pikën 2, duhet të jenë të hedhura në librezën e automjetit, të lëshuar nga organi përkatës.

III.1.14. Në nenin 210 “Pajisjet e makinave teknologjike” të VKM nr. 153, datë 07.04.2000 “Për Miratimin e Rregullores së Zbatimit të Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar parashikohet se:

1. Makinat teknologjike duhet të jenë të miratuara dhe të verifikuara me mjete të ndryshme ndërmjet tyre, në kushte që sistemi i punës të mos pësojë ndryshime, sipas përcaktimeve të bëra në udhëzimin e Ministrisë së Transportit.

III.1.15. Në nenin 280 “Sinjalizimi i makinave teknologjike, jashtë norme” të VKM nr. 153, datë 07.04.2000 “Për Miratimin e Rregullores së Zbatimit të Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar parashikohet se:

1. Makinat teknologjike, që për nevoja funksionale, i kalojnë përmasat e parashikuara nën 113 i Kodit Rrugor, duhet të vihen në dukje me anë të paneleve, të miratuara sipas kriterëve të përcaktuara nga ministri i Transportit, i cili përcakton rregullat, numrin dhe vendmontimin e paneleve të sipërpërmendura, si dhe sinjalizimet e tjera, të nevojshme.

III.1.16. Në nenin 281 “Fushëpamja e makinave teknologjike” të VKM nr. 153, datë 07.04.2000 “Për Miratimin e Rregullores së Zbatimit të Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar parashikohet se:

1. Fushëpamja e makinave teknologjike, për të cilën është folur në nenin 58 të Kodit Rrugor, duhet të kontrollohet sipas rregullave teknike, të përcaktuara në udhëzimin e Ministrit të Transportit me udhëzim të tij.

III.1.17. Në nenin 282 “Regjistrimi dhe vendosja e targës së makinave teknologjike” të VKM nr. 153, datë 07.04.2000 “Për Miratimin e Rregullores së Zbatimit të Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar parashikohet se:

1. Makinat, të cilat lejohen të qarkullojnë në rrugë sipas nenit 113 të Kodit Rrugor, duhet të regjistrohen pranë degës së DRSHTRR-së së rrethit përkatës, që merret me nxjerrjen e lejes së qarkullimit dhe të targës së atij që deklarohet pronar i mjetit.

2. Pronari i makinës teknologjike duhet të shënojë, në kërkesën e regjistrimit të mjetit, të dhënat e gjendjes civile dhe adresën.

3. Po në këtë kërkesë, nëse është e nevojshme, duhet të shënohen të dhënat e plota të ndërmarrjes së cilës i është besuar përdorimi i makinës teknologjike. Ky detyrim nuk kërkohet

për makinat teknologjike, vetëlëvizëse, të pajisura me motor me fuqi jo më të madhe se 50 kw. Po kështu, ky detyrim nuk kërkohet për makina teknologjike, si vagoneta rrëshqitëse, motokarro, rula për të shtruar, makina për mbartjen e shinave dhe të ngjashme me to, për ato të caktuara për finiturën dhe trajtimin e mbulesës së rrugës, si dhe për makinat teknologjike që tërhiqen.

4. Në rastin e daljes nga qarkullimi të një makine teknologjike, pronari duhet të njoftojë njërën nga degët përkatëse të DRSHTRR-së, si dhe të kthejë targën e regjistrimit dhe lejen përkatëse të qarkullimit. Zyra e mësipërme lëshon dëftesën përkatëse dhe merr masa për asgjësimin e targës, për anulimin e lejes së qarkullimit dhe ndryshimet që pasojnë, të cilat arkivohen në arkivin përkatës.

5. Për daljen e përkohshme nga qarkullimi të makinës teknologjike, pronari i makinës teknologjike duhet të njoftojë njërën nga degët përkatëse të DRSHTRR-së, duke treguar depozituesin e mjetit në ruajtje, si dhe selinë e tij.

III.1.18. Në nenin 287 “Makina teknologjike me masë jashtë norme” të VKM nr. 153, datë 07.04.2000 “Për Miratimin e Rregullores së Zbatimit të Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar parashikohet se:

1. Masa që peshon mbi aksin më të ngarkuar të makinave teknologjike jashtë norme, nuk duhet të jetë më e madhe se 13 tonë; vlera më të mëdha së 13 tonë mund të lejohen me kusht që shpejtësia maksimale, e llogaritur dhe e kontrolluar me mënyrat e parashikuara nga neni 208, nuk i kalon kufijtë e mëposhtëm:

a) 25 km/orë për masa mbi 13 tonë dhe jo më të mëdha se 18 tonë;

b) 15 km/orë për masë më të madhe se 18 tonë.

2. Masat e treguara më sipër janë të lejuara edhe mbi akset e tjerë, mjaft që largësia ndërmjet tyre të jetë më e madhe se 1.20 m. Këto akse duhet të jenë të pajisura me varje elastike dhe duhet të kompensojnë ndërmjet tyre ngarkesën për disnivele reciproke prej 10 cm; maksimumi i ngarkesës nuk duhet të kalojë ± 25 për qind të peshës që ushtrohet mbi çdo aks, në kushte të bashkërrafshësisë

III.1.19. Në nenin 288 “Kontrolli i makinave teknologjike në qarkullim” të VKM nr. 153, datë 07.04.2000 “Për Miratimin e Rregullores së Zbatimit të Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar parashikohet se:

1. Kontrolli i makinave teknologjike të regjistruara është përcaktuar në udhëzimin e ministrit të Transportit, dhe përsëritet jo më pak se në 2 vjet, duke u nisur nga data e parë e regjistrimit të vetë makinës teknologjike.

2. Kërkesat minimale të sigurisë, të miratuara sipas udhëzimit për të cilin është folur në pikën 1 janë, për sa është e zbatueshme, për këto mjete me masë të përgjithshme të përcaktuar në shtojcën VIII të këtij kapitulli.

III.1.20. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale,

kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit. Për pasojë, Komisioni gjykon, se operatorët ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi duhet të plotësojnë vetëm kërkesat e vendosura në dokumentet e tenderit, e rrjedhimisht, vlerësimi e kualifikimi i tyre duhet të bëhet në përputhje vetëm me këto kërkesa.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në SPE si dhe referuar edhe dokumentacionit fizik të dërguar nga autoriteti kontraktor me shkresën nr. 2346/1 prot, datë 08.08.2025, protokolluar me tonën me nr. 1725/7 prot., datë 11.08.2025, Komisioni konstaton, se ky operatori ekonomik ka ngarkuar në SPE shtojcën 8 “*Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit*” si dhe ka dorëzuar pranë autoritetit kontraktor në zbatim të nenit 26 të VKM-së dokumentacionin në lidhje me vërtetueshmërinë e plotësimin të kriterëve të kualifikimit të vetëdeklaruar në shtojcën 8, ku deklaroi mjetet dhe makineritë, referuar kriterit të parashikuar në pikën 2.3.9 të dokumenteve standarde të tenderit operatori ekonomik ka deklaruar në shtojcë (Llojin e mjetit, Targën e mjetit, Nr. Lejes qarkullimit të mjetit, Nr. Shasisë së mjetit, duke evidencuar

C: DEKLARATË

“PËR DISPONIMIN E MJETEVE/PAJISJE/MAKINERIVE TË NEVOJSHME PËR REALIZIMIN E PUNIMEVE OBJEKT KONTRATE”

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time se, kam në dispozicion dhe/ose do të me vihen në dispozicion mjetet, pajisjet teknike dhe asetet e tjera fizike për të realizuar këtë kontratë, si me poshte:

Në pronësi				
Lloji i Mjetit	Targa	Nr. Lejes qarkullimit	Nr. Shasisë	Të tjera
Eskavator me goma 0.25m3 (MT)		1		
Fadroma				
Kamionë vetshkarkues me kapacitet mbajtës 10 -20 Ton				
Kamion vetshkarkues me kapacitet mbajtës 8 -10 ton				
3 copë				
Kamioncine me kapacitet mbajtës 3.5-5 ton		B		
Kamioncine me kapacitet mbajtës 1-3 ton				
Autovinç me kapacitete mbajtës minimum 50 ton				
Autovinç me kosh me kapacitet mbajtës minimal 1 ton				
Autopompë Betoni				

Autobetonierë					
Mjet për transport kapacitete mbajtës jo më pak se 35 ton (Dampera teknologjike)					
Kokë terheqese					
Rimorkiator peshë mbajtëse jo më pak se 45 ton					
Pompë suvatimi					
Depozitë uji jo më pak se 5000 l					
Helikopter nivelues					
Skeleri					
Autobetoniere kantieri					
Instrument për punime gjeodezike					
Fabrike Betoni					
Eskavator me pincë (Tranxhë Hidraulike) jo me pak se 30 ton					
Kontener Stacioner (zyra, ndrrës)					
Kompleti ndihmes se shpejte					
Kokore					
Fikesezjarri të levizshme me kapacitet 5-7 litra					
Prozektore ndriçimi naten					
Tabela paralajmeruese për sigurimin e perimetrit kantier					

Me qira					
Lloji i Mjetit	Targa e mjetit	Nr. Lejes qarkullimit të mjetit	Nr. Shasisë së mjetit	Nr. Kont së qerasë (noterisë)	Afati i kontratës qerasë (data e fillimit dhe mbarimit)
Sondë për pilota thellesia minimum 10 m jo me pak se 80 ton (Diametri sipas specifikimeve të zërit)					
Pincë (Tranxhë Hidraulike)					

Kontratë furnizimi			
Materiali/prodakti për të cilin paraqitet kontrata e furnizimit	Nr. Kont së furnizimit (noterisë)	Afati i kontratës furnizimit (data e fillimit dhe mbarimit)	Të tjera

III.1.21. Referuar sa më sipër KPP gjykon, se operatori ekonomik në lidhje me deklarin e të dhënave të mjeteve, nga verifikimi i shtojcës 8 “Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit” rezulton se e ka përmbushur kriterin e veçantë të kualifikimit të parashikuar në pikën 2.3.9. Për sa i përket mjeteve të pretenduara nga operatori ekonomik ankimues që nuk disponojnë dokumentacionin të rregullt sipas kërkesave të autoritetit mkontraktor, operatori ekonomik “Salillari” SHPK ka deklaruar duke plotësuar të gjitha fushat e kërkuara në tabelën e mjeteve me qera/pronësi, tek seksioni respektiv të Formularit përmbledhës të vetdeklarimit të paraqitur si dhe ka dërguar dokumentacionit fizik provues, me shkresën nr. 2346/1 prot., me datë 08.08.2025, protokolluar me tonën me nr. 1725/7 prot., datë 11.08.2025, me objekt “Dërgim

dokumentacioni lidhur me ankesën e operatorit ekonomik Salillari shpk". KPP gjykon, se nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur nga autoriteti kontraktor me shkresën e sipërcituar rezulton, se për të gjitha mjetet e deklarauara në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, ka deklaruar se disponon me kontratë qeraje/ pronësi të gjitha mjetet, duke përmbushur numrin total të kërkuar të tyre, dhe secili mjet është me dokumentacion shoqërues me leje qarkullimi, certifikatën e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit (te vlefshme), certifikatën pronësisë së mjetit, foton e mjetit. Për sa i përket mjeteve të pretenduara (Kamion vetshkarkues me kapacitetmbajtës 8 -10 ton me Targë BR 5216 A me tonazh 10.3 ton; Kamion vetshkarkues me kapacitetmbajtës 8 -10 ton me Targë AA 217 PR me tonazh 10.5 ton) që nuk përmbushin tonazhin e kërkuar, Komisioni nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar nga autoriteti kontraktor konstaton se mjetet e sipërcituara jo vetëm që e përmbushin kriterin e tonazhit por edhe e tejkalojnë atë, dhe sasitë në copë të kërkuara nga autoriteti kontraktor.

- Ndërsa në lidhje me arsyen e skualifikimit për sa i përket mjetit për transport kapacitete mbajtës jo më pak se 35 ton (Dampera teknologjike) operatori ekonomik ka paraqitur ndër të tjera edhe dokumentacionin Faturë tatimore shitje nr. 217, datë 20.06.2012 me përshkrim Damper Cat Model 771 D SN 6YS00427 + Foto dhe Faturë tatimore shitje nr. 205, datë 07.06.2012 me përshkrim Damper Cat Model 771 D SN 6YS00261 + Foto. Pretendimi i autoritetit kontraktor se për këto dy mjete nuk është paraqitur dokumentacioni, Komisioni gjykon se argumentimi i Komisionit të Vlerësimit të Ofertave dhe Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave nuk qëndron, pasi ka interpretuar gabim përcaktimet e nenit 58, të ligjit nr. 8378, datë 22.07.1998 "*Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë*", i ndryshuar, ku në këtë dispozitë përcaktohet se cilat mjete klasifikohen si "*mjete teknologjike*" dhe fakti që këto mjete janë me goma jo domosdoshmërisht përcakton dhe detyrimin që të pajisen me targa, ndërkohë që në interpretim të përcaktimeve të nenit 113 të ligjit nr. 8378, datë 22.07.1998 "*Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë*", i ndryshuar, të gjitha kategoritë e mjeteve (të përcaktuara në nenin 47 të ligjit nr. 8378, datë 22.07.1998 "*Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë*", i ndryshuar) përfshirë dhe mjetet teknologjike në momentin kur qarkullojnë në rrugë duhet të jenë të pajisur me targa, ndërsa në rastin kur lëvizin vetëm në kantier atëherë nuk kanë detyrim që të pajisen me targa. Edhe neni 282 "*Regjistrimi dhe vendosja e targës së makinave teknologjike*" të VKM nr. 153, datë 07.04.2000 "*Për Miratimin e Rregullores së Zbatimit të Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë*", i ndryshuar parashikon se "*Makinat, të cilat lejohen të qarkullojnë në rrugë sipas nenit 113 të Kodit Rrugor, duhet të regjistrohen pranë degës së DRSHTRR-së së rrethit përkatës, që merret me nxjerrjen e lejes së qarkullimit dhe të targës së atij që deklarohet pronar i mjetit*". Për sa kohë që legjislacioni posacëm nuk e parashikon të detyrueshme regjistrimin dhe targimin e mjeteve teknologjike, atëherë edhe pretendimi i autoritetit kontraktor për këtë arsye skualifikimi nuk është e saktë, pasi në nenin 282 të Vendimit të sipërcituar në pikën 3 të tij parashikon se ky detyrim nuk kërkohet për makinat teknologjike, vetëlëvizëse, të pajisura me motor me fuqi jo më të madhe se 50 kw. Po kështu, ky detyrim nuk kërkohet për makina teknologjike, si vagoneta rrëshqitëse, motokarro, rula për të shtruar, makina për mbartjen e shinave dhe të ngjashme me to, për ato të caktuara për finiturën dhe trajtimin e mbulesës së rrugës, si dhe për makinat teknologjike që tërhiqen. Nga kjo dispozitë qartësisht është e kuptueshme se regjistrimi i mjeteve teknologjike është i detyrueshëm vetëm në rastet se këto mjete do të qarkullojnë në rrugë, në rast se këto mjete do të qarkullojnë në kantier nuk është e nevojshme, gjithashtu ky nen përbën edhe raste përjashtimore ashtu sikurse

mësipërcituam. Komisioni sqaron se në kushtet kur Komisioni i Vlerësimit të Ofertave edhe Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës ka patur paqartësi, duhet t'i kërkonte sqarime ofertuesit, apo organeve të caktuara me ligj të posaçëm pasi në kushtet kur nuk është i qartë, nuk mund të referojë një arsye skualifikimi të tillë. KPP gjykon, se me dokumentacionin e paraqitur operatori ekonomik dëshmon se disponon mjetet e kërkuara sipas kërkesave të autoritetit kontraktor.

Për më tepër, Komisioni i Prokurimit Publik sqaron, se përfituesi i drejtpërdrejtë i objektit të prokurimit është vetë autoriteti kontraktor dhe si i tillë ai ka një pozitë të veçantë dhe është përgjegjës për ndjekjen dhe monitorimin e zbatimit të kontratës sipas legjislacionit në fuqi, kjo bazuar në nenin 124 të LPP-së ku përcaktohet se: *“1. Autoriteti ose enti kontraktor ka detyrimin të ndjekë zbatimin e kontratës sipas kushteve në bazë të të cilave është nënshkruar, për të garantuar se ajo zbatohet në kohën, cilësinë dhe vlerën e përcaktuar, në përputhje me kushtet e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe me legjislacionin në fuqi. 2. Për monitorimin e zbatimit të kontratës, autoriteti ose enti kontraktor, nisur nga natyra e objektit të kontratës dhe kohëzgjatja e zbatimit të saj, harton planin e zbatimit të kontratës, duke përfshirë në veçanti çështjet organizative, afatet, çështjet ekonomike e teknike të kontratës së nënshkruar, në përputhje me çdo akt tjetër ligjor. 3. Planin e zbatimit të kontratës duhet të nënshkruhet nga autoriteti ose enti kontraktor dhe operatori ekonomik brenda 7 ditëve nga nënshkrimi i kontratës dhe në çdo rast para fillimit të zbatimit të saj. 4. Çdo modifikim i kontratës në përputhje me nenin 127 të këtij ligji, pasqyrohet në planin e zbatimit. 5. Autoriteti ose enti kontraktor, në përputhje me planin, ndjek zbatimin e kontratës, administron dokumentacionin e monitorimit dhe harton raportet e monitorimit. 6. Rregulla të hollësishme për monitorimin e zbatimit të kontratave, sipas tipologjive të tyre, përcaktohen nga rregullat e prokurimit publik. Autoriteti kontraktor duhet të kryejë pagesat në favor të operatorëve ekonomikë, në përputhje me parashikimet e legjislacionit të fushës në fuqi.”* Pra është autoriteti kontraktor si organi me interes dhe përgjegjësi për realizimin me sukses të kontratës, është pikërisht ai që duhet të monitorojë zbatimin e kontratës për t'u siguruar nëse cilësia e punëve të kërkuara është e njëjtë me cilësinë e premtuar në ofertë dhe të përcaktuar në kontratë.

Për sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “Salillari” SHPK qëndron.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023 “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Salillari” SHPK për procedurën e prokurimit “*Procedure e hapur*”, me Nr. REF-31297-11-27-2024, me objekt: “*Ndërtimi i godinës së Bashkisë*”, me fond limit 108.333.333 (*njëqind e tetë milion e treqind e tridhjetë e tre mijë e treqind e tridhjetë e tre*) lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 26.12.2024, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Dimal.
 2. Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO-së, për skualifikimin e operatorit ekonomik “Salillari” SHPK dhe të korrigjojë shkeljet e konstatuara si më sipër, duke e kualifikuar këtë operator ekonomik.
 3. Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
 4. Ngarkohet zyra e financës, që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Salillari” SHPK.
 5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
 6. Kopje e këtij vendimi, i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Gjergj Mersini

Nënkryetar
Fiorent Zguro

